

Të drejtat e njeriut dhe përdoruesit e drogës në Shqipëri

Vetëm të drejtat mund të ndalojnë padrejtësitë

Ky botim mundësohet në kuadër të projektit “Rrjeti për Zbatimin e Dënimeve Alternative” i zbatuar nga këto organizata: Aksion Plus; Përthyerje, Strehëza për Gratë e Dhunuara, realizuar me:


Me mbështetjen financiare të:

Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri



Bankës Botërore



 Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë
SOROS

Përgatitën për botim:

Eglantina Bardhi, gazetare
Genci Mucollari
Marinela Sota
Entela Kaleshi
Enkelejda Ngjelina
Fiona Lalaj
Erlind Plaku

Fotografitë u realizuan nga:
Denis Vogli

Tiranë 2010

KUSHTETUTA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 30

1. Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 55

1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.
2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.

Përdoruesit e drogës mund të kenë pasoja serioze për shëndetin dhe mirëqenien sociale. Ata shpesh nuk përfitojnë nga shërbimet e shëndetit publik si pasojë e stigmës dhe diskriminimit. Pasojat shëndetësore të përdorimit të drogave (veçanërisht të atyre që injektojnë) do të vijnë në të vërtetë, ndërsa rritet gjithashtu dhe barra e disa sëmundjeve të tjera që lidhen me përdorimin e

drogës. Epidemitë e malarjes, tetanozit, hepatiti C (HCV), infeksione të tjera me natyrë parazite apo bakteriale, bashkë me disa sëmundje të tjera, i atribuohen përdorimit të drogave. Një seri e gjerë e komplikacioneve infektive e lidhur me injektimin e drogave është dokumentuar që në raportet të hershme. Infeksioni i HIV-it ka marrë përmasa dramatike dhe ka ndryshuar perceptimin e grupeve të përdoruesve të drogës.

Vendet e Europës Lindore dhe Qëndrore po përjetojnë një rritje të shpejtë të epidemisë së HIV-it, sidomos midis përdoruesve të drogës, kjo sepse shumica e tyre ndodhen pranë rrugëve të trafikut të drogës nga Afganistani drejt vendeve perëndimore dhe SHBA-së. Sipas UNODC-së ky fenomen është duke u zgjeruar, sepse dhe prodhimi i opiumit dhe kokainës po rritet. Gjithashtu Shqipëria është një vend ku prodhohet dhe trafikohet drogë, pra si rrjedhojë pritet që numri i përdoruesve të rritet dita-ditës. Raportet nga klientë që vizitojnë qendrën e Aksion Plus-it, tregojnë se mosha e fillimit të përdorimit të drogës është 13-14 vjeç, dhe shumica e tyre kanë një histori 8-10 vjeçare të përdorimit të disa drogave. Fillimisht ata kanë përdorur droga të ashtuquajtura të lehta, për të kaluar më tej në droga të “rënda” si heroina, dhe shumë prej tyre tashmë e injektojnë heroinën.

Shumica e përdoruesve përdorin kanabis, por ka një rritje të personave që janë të varur nga heroina. Problemi i drogës është shtrirë në mbarë vendin, por është më akut në zonat urbane të Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Fierit, Lushnjës, Korçës si dhe Gramshit. Vdekjet nga mbidoza kanë qenë rreth 40, por statistikat mund të jenë më të larta si pasojë e mosraportimeve të sakta. Përdorimi intravenoz i drogave është një shkak themelor për përhapjen e HIV/SIDA dhe infeksioneve të tjera seksualisht të transmetueshme. Vlerësohet se rreth 5000-6000 përdorues injektojnë, kryesisht heroinë, si dhe përdorin të njëjtat shiringa duke shtuar rreziqet për shëndetin e përdoruesit (Raport i ISHP-së për EMCDDA – 2009).

Kohët e fundit kemi një rritje të përdoruesve midis anëtarëve të komunitetit Rom (Aksion Plus, raport vjetor 2010). Ky komunitet, përveç drogës është i prekur nga papunësia, varfëria e thellë, akses i ulët ndaj shërbimeve shëndetësore. Sipas të dhënave nga ISHP-ja, mosha mesatare e romëve që kanë përdorur drogë për herë të parë është rreth 15 vjeç. Disa prej romëve tregojnë për raste kur kanë parë miqtë e tyre të injektojnë drogë me shiringa të përdorura më parë nga të tjerët. Romët gjithashtu kanë një nivel të ulët informacioni, dhe injektojnë në kushte të këqija higjienike, duke shtuar kështu edhe rreziqe të tjera shëndetësore.

Marrja e drogës bëhet në shtëpi apo zona të braktisura në lagje, poshtë urave apo në bregun e lumit të Tiranës.

Shërbimet që ofrohen për përdoruesit e drogave

Cilësia dhe llojet e shërbimeve të ofruara nga shërbimet shëndetësore ekzistuese kanë rënë, dhe këto shërbime e përballojnë me vështirësi situatën në vend.

Klinika Toksikologjike në Spitalin Ushtarak ofron trajtim për përdoruesit e drogave, por ka një kapacitet të kufizuar me 15 shtretër, dhe nuk është një klinikë e specializuar për trajtimin e drogave.

Një qendër tjetër për trajtimin e përdoruesve të drogës është qendra Emanuel, e cila administrohet nga një shoqatë italiane. Është themeluar në vitin 2000 dhe ofron një trajtim afat-gjatë rezidencial.

Shoqata Aksion Plus është një organizatë e krijuar që në vitin 1992 dhe ofron një shërbim trajtimi dhe rehabilitimi në tre nivele për përdoruesit e drogave, si dhe aktivitete sensibilizimi për të rinjtë që ndjekin shkollat e mesme dhe jashtë tyre.

Niveli i parë, ai parandalues, u drejtohet të rinjve që nuk kanë hyrë në rrugën e drogës, ose sapo kanë filluar të eksperimentojnë me drogat, pa kaluar në injektim.

Niveli i dytë ofron shërbimet e zvogëlimit të dëmit për përdoruesit aktivë, sidomos ata që injektojnë. Përveç shiringave të pastra, punonjësit e terrenit japin prezervativë, materiale informative, vitamina apo medikamente për përdoruesit në gjendje të vështirë ekonomike dhe shëndetësore, si dhe i adresojnë përdoruesit në shërbime të tjera të specializuara. Gjithashtu programe të tilla ndihmojnë në:

- uljen e rasteve të injektimit
- zvogëlojnë frekuencën e injektimit
- ndalojnë/zvogëlojnë ripërdorimin e shiringave dhe paisjeve të tjera të injektimit
- Rrisin shkallën e dezinfektimit të ageve dhe shiringave
- Rrisin mundësinë e pjesmarrjes në programet e trajtimit të drogave
- Rrisin përdorimin e prezervativit dhe të metodave të tjera kontraceptive.

Niveli i tretë operon në qendrën e Terapisë me Metadon, një projekt i mbështetur fillimisht nga nga OSFA dhe tani nga Fondi Global i Luftës kundër AIDS dhe TB, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë. Terapia me metadon ofrohet për përdorues me karrierë të gjatë të përdorimit të drogave, venat e të cilëve janë të dëmtuara dhe më gjendje shëndetësore të rëndë. Përveç Tiranës terapia me metadon është shtrirë dhe në rrethe të tjera si: Durrësi, Elbasani, Korça, Vlora dhe Shkodra. Studime të ndryshme në nivel ndërkombëtar pohojnë se shërbime të tilla janë efektive në terma ekonomikë, shëndetësorë, individualë dhe socialë.

Të tre këto nivele janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin, por ende mbetet shumë për të bërë, sepse dhe problemet janë më të ndërlikuar se sa duken. Një përdorues në familje është një problem serioz dhe i papërbalueshëm nga familja. Drama që e shoqëron problemin e drogës, rëndohet nga probleme financiare të trajtimit, dhunës si dhe përfshirjes në aktivitete kriminale të përdoruesve të drogës. Terapia me metadon e ofruar në qendrat e ngritura nga Aksion Plus është cilësuar e suksesshme, gjë që vërehet nga ecuria pozitive e individëve, dhe nga marrëdhënjet e përmirësuara familjare dhe shoqërore. Niveli i vetë-vlerësimit është rritur, dhe shumë nga klientët kanë filluar punë.

Këto ndërhyrje dhe projekte janë bërë të mundur nga mbështetja e donatorëve si BE, Banka Botërore, Soros, UNFPA, UNODC, ICCO, UNICEF, CIDA, SDC, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Përdoruesit e drogave me injektim po përpiqen ta ruajnë shëndetin e tyre ndërsa vazhdojnë të përdorin droga. Shëndeti i tyre gjithashtu prek dhe shëndetin e qenieve të tjera përreth tyre sepse ata jetojnë në të njëjtin mjedis.

Për të qenë efektive në parandalimin e epidemisë midis përdoruesve të drogave me injektim (ose për të kontrolluar epideminë që sapo ka nisur) UNAIDS-i vlerëson që programet e shkëmbimit të

shiringave duhet të kapin 60-70% të injektuesve me informacion dhe edukim, dhe pothuaj 20% të tyre me shiringa sterile në mënyrë të përhershme. Dihet që në Shqipëri programet e zvogëlimit të dëmit, apo të trajtimit të drogës janë në nivel shumë të kufizuar. Kostot e shumta që duhet të përballojë shteti në të ardhmen do të jenë shumë më të larta, nëse nuk ndërhyhet në kohë. Në përgjithësi për çdo dollar të harxhuar në programet e zvogëlimit të dëmit, qeveria kursen 10-15 dollarë.

Narkotikët Anonimë

Narkotikët Anonimë (NA) janë një shoqatë që u krijuan prej Alkolistëve Anonimë rreth viteve 40-të. Takimet e para të NA u zhvilluan në Los Anxhelos rreth viteve 50-të në formën e një organizate, e cila tani është shtrirë si një rrjet i madh në mbarë botën. Brenda pak viteve organizate të NA-së u krijuan në Brazil, Kolumbi, Gjermani, Itali, Indi, Zelanda e Re, Angli, por dhe në vende fqinje si Mali i Zi, Kroaci etj.

Në ditët e sotme organizata është shndërruar në një vëllazëri shumë-gjuhëshe, shumë-kulturore me më shumë se 58 000 takime javore në 131 vende të botës.

Pamfleti më i hershëm i NA-së i njohur si “Broshura e Bardhë” e përshkruan NA-në si më poshtë: “NA-ja është një vëllazëri burrash dhe grash, pa qëllim fitimprurës për të cilët droga është një problem serioz. Ne takohemi rregullisht për të ndihmuar njëri-tjetrin për të qëndruar larg drogës. Ne nuk i japim rëndësi çfarë dhe sa ke përdorur... por vetëm në atë se çfarë ti dëshiron të bësh rreth problemit tuaj, dhe se si ne mund të ndihmojmë. Shumica e atyre që janë anëtarë të NA-së janë të pastër nga drogat për një kohë të gjatë, dhe janë të aftë të ndihmojnë anëtarët e rinj. Parimet e tyre mbështeten mbi vlera shpirtërore dhe tradicionale, dhe kjo është forca dinamike që sjell unitetin në këtë program. Kredo e tyre është se: “Një herë përdorues, gjithmonë përdorues, nuk mund të tolerohet më nga shoqëria apo vetë përdoruesit. Ne do shërohemi”.

(Fragment i marrë nga *Narcotics Anonymous World Services, Inc.* www.na.org).

Më poshtë pa japim një fragment nga broshura e tyre “Vetëm për Sot”

Vetëm për Sot

Thuaji vetes:

Vetëm për sot, mendimet e mia do të përqendrohen në shërimin tim duke jetuar dhe shijuar jetën pa varësinë e drogës.

Vetëm për sot, unë do të besoj dikë nga përdoruesit anonim që beson dhe dëshiron të ndihmojë në shërimin tim.

Vetëm për sot, unë do t'i nënshtrohem një programi dhe do të përpiqem të jap më të mirën e vetes.

Vetëm për sot, përmes përdoruesve anonimë do të siguroj një perspektivë më të mirë për jetën time.

Vetëm për sot, nuk do të kem frikë. Mendimet e mia do të përqendrohen në dimensione të reja, tek njerëzit që nuk kanë më varësi prej drogës, dhe që kanë gjetur një rrugë të re në jetë. Derisa ajo rrugë të ekzistojë nuk kam përse të kem frikë.

Kur ne fillojmë programin e Përdoruesve Anonimë, jetët tona marrin një kthesë të patjetërsueshme. Me ndihmën e një Fuqie të Lartë, na lehtësohet barra e së shkuarës dhe frika për të ardhmen. Jemi përpara një perspektive të re. Ne pranojmë dhe shijojmë jetën ashtu siç na ofrohet në tashmen. Kur

ne refuzojmë të pranojmë realitetin e ofruar ne mohojmë besimin tonë tek Zoti. Kjo sigurisht sjell vetëm vuajtje.

Ne mësojmë se e sotmja është një dhuratë pa garanci. Në këtë kuptim, domethënia e së kaluarës dhe së ardhmes dhe rëndësia e veprimeve tona bëhet reale për ne. Kjo e bën jetën më të lehtë dhe më të thjeshtë.

Kur ne fokusohemi në realitetin e sotëm, shpëtojmë nga makthi i së shkuarës, me shpresën e një mundësie të dytë në të ardhmen. Në këtë gjendje brishtësie e konfuzioni ne zbulojmë se mund t'ia besojmë ndjenjat, mendimet dhe përvojat tona më të fshehta dikujt me të njëjtat probleme si ne, dhe zbulojmë se nuk jemi të vetëm në problemin tone, por me ndihmën e grupit të përdoruesve anonimë ne përballojmë dhimbjen e së shkuarës dhe mundësojmë një perspektive të re.

Ne nuk kemi motiv për t'u frikësuar në rast se sot nuk përdorim drogë, me besimin në Zot dhe pranë miqve përdorues anonimë. Zoti na ka falur gabimet e së shkuarës dhe e nesërmja nuk ka ardhur ende. “Vetëm për sot”, si program teorik apo si praktike, zbatohet në të gjitha sferat e jetës sonë, jo vetëm në atë të varësisë së drogës. Realiteti ynë është ai i ditës në të cilën jetojmë. Shumë prej nesh besojnë se Zoti pret prej nesh asgjë më shumë se gjërat që mund të bëjmë gjatë një dite.

Programin i dymbëdhjetë hapave të përdoruesve anonimë na ka dhuruar një botëkuptim të ri në jetët tona. Sot ne nuk justifikohemi më për atë çka jemi. Besimi tek Zoti ka përmbushur zbrazëtinë tonë. Ne gjejmë tek Ai motiv për të përballuar çdo ditë dhe për të mos rënë në kurthin e varësisë së drogës.

Duhet të theksojmë se për çdo përdorues shmangia e përdorimit të drogës qoftë dhe për një ditë është një mrekulli. Duke shkuar nëpër takime, duke punuar me etapat e programit, ndërmjetësimi sistematik, dhe duke ndarë përvojat me përdoruesit të përfshirë në program janë disa nga përpjekjet që ne bëjmë për të qëndruar shpirtërisht të shëndetshëm. Ne mund të zevendësojmë vetminë dhe frikën me dashurinë, harmoninë dhe sigurinë e një jete të re. Ne nuk do të jemi më kurrë vetëm. Në programin e përdoruesve anonimë ne kemi krijuar miqësi të vërtetë ashtu siç nuk kishim besuar se do të mendonim. Ndjenjat e fajësisë, keqardhjes dhe hakmarrjes i kanë lënë vendin tolerancës dhe besimit.

Gjatë një dite të vetme ndodhin shumë gjëra të karakterit pozitiv dhe negativ. Në rast se na mungon vigjilenca për të vlerësuar siç duhet momentet kyçe ne ndërpresim rritjen, zhvillimin dhe realizimin tonë si individë. Lumturia, besimi, filozofia dhe dashuria janë udhërrëfyesit tanë përgjate rrugës tonë të shërimit, duke luftuar ditë pas dite deri në shërimin përfundimtar.

Media për drogat

Policia ka identifikuar zonat ku shitet droga, por e ka jo të lehtë kapjen e shpërndarësve

Harta dhe rrugët e drogës në Tiranë

Ja zonat ku shpërndahet kokaina dhe heroina në kryeqytet. Mënyra e shpërndarjes dhe çmimet

TIRANË- Antidroga identifikon zonat e shpërndarjes së drogës në Tiranë. Zyra e antidrogës pranë policisë së kryeqytetit disponon një hartë në të cilën janë rrethuar zonat më të nxehta për shitjen e

lëndës narkotike; heroinë, kokainë, cannabis-sativa. “Kinostudio”, “Alliasi”, “Rruga e Kavajës”, “Bërryli”, “21 Dhjetori” “Zogu i Zi”, dhe “ish-Bloku” janë vendet më të frekuentuara nga shpërndarësit e drogës. Pavarësisht se policia ka mundur të identifikojë zonat ku shitet droga e ka jo pak të vështirë identifikimin dhe kapjen e shpërndarësve. Kjo për arsye se ata janë shumë të kujdesshëm dhe nuk përzihen me persona që nuk i njohin. Shitësit e drogës kanë klientët e tyre të cilëve ua japin dorazi sasinë e drogës ndërsa mbajnë shumë rezerva duke mos iu treguar atyre emrin e vërtetë.

Shpërndarësit

Furnizohen të trafikantët “grosistë” dhe më pas krijojnë lidhjet e tyre për të shitur drogën. Pasi marrin porosinë nga klientët, shpërndarësit sigurojnë lëndën narkotike dhe paraqiten në vendin e takimit i cili mund të ndryshohet herë pas here. Madje edhe kur takohen klienti e shpërndarësi, qëndrojnë vetëm për pak sekonda sa mjafton për shkëmbimin e mallit me paratë. Gjithmonë shitësit mbajnë shumë pak doza me vete, kjo për t’iu ruajtur antidrogës e cila në rast se i kontrollon i sekuestron një sasi të vogël droge, me të cilën shpërndarësit mund të justifikohet se e ka për përdorim vetjak. Pjesën tjetër të drogës e fshehin në vende të sigurta në banesat e tyre. Ndërkohë që për të shmangur ndjekjen e policisë, shpërndarësit kamuflojnë me qëndrimin dhe identitetin e tyre. Ata evitojnë njerëzit e panjohur, ndërsa klientët i thërrasin me pseudonime. Gjithashtu numrat e telefonit nuk i mbajnë gjatë në përdorim, megjithëse në biseda telefonike flasin gjithnjë me kode.

Antidroga

Policia e ka mjaft të vështirë kapjen e shitësve të drogës, pasi ata dinë mirë të ruhen. Hetimi standard që policia kryen është ndjekja e përdoruesit të drogës. Dihet që ky i fundit do të takohet me shpërndarësin për të blerë drogën, duke çuar dhe policinë e cila e ka survejuar për një periudhë kohe të caktuar. Nuk janë të paktat rastet kur policia e Tiranës ka deklaruar zyrtarisht se ka bërë të mundur kapjen e shpërndarësve të drogës në sajë të ndjekjes së përdoruesit. Është e pamundur të bindësh përdoruesin të tregojë shpërndarësin pasi ai thotë se nuk ia di emrin dhe se nuk e mban mend edhe nëse e sheh. Ndërkohë që në raste sporadike policia ka mundur të zbulojë rrjete droge duke përdorur metoda të tjera hetimi. Gjithashtu nuk janë të pakta rastet kur policia ka goditur trafikantë droge me anë të agjentit të infiltruar.

Drogat

Marijuanë, heroinë e më pas kokaina, janë drogat që shpërndahen në kryeqytet. Në tregun e drogës kryeson Marijuana e cila shitet më tepër në kryeqytet për t’u pasuar me heroinën, ndërsa më pak shitet “droga e bosave” siç quhet ndryshe kokaina. E shtrenjtë dhe droga që nuk krijon varësi, pëlqehet më shuma nga personat “VIP” të pasur, të cilët janë konsumatorët e kokainës. Por pavarësisht kësaj, kjo nuk e ka ndihmuar policinë të zbulojë trafikantët e kësaj droge duke i cilësuar goditje të rralla të për antidrogën. Në fakt vetëm pak ditë më parë, policia e Tiranës ndaloi pranë fakultetit të Drejtësisë dy persona të cilët posedonin një sasi prej 325 gramë drogë e llojit kokainë.

Mbi 6 mijë përdorues droge në Tiranë

Janë mbi 6 mijë përdorues drogë në Tiranë. Marijuana dhe heroina ka çuar në 6 mijë konsumatorët. Megjithëse në kryeqytet ka qendra rehabilitimi për përdoruesit e lëndëve narkotike kjo gjë nuk ka ndikuar në uljen e përdoruesve madje numri i tyre është shtuar vitin e fundit. Një pjesë e mirë e përdoruesve lëvizin në lagjen “Kinostudio” e “Alias” ku blejnë dhe heroinën apo Marijuanën. Burimet policore thanë se moshja e përdoruesve të drogës është 17-30 vjeç. Ndërkohë që në radhët e përdoruesve të drogës ka edhe femra, numri i të cilave është mjaft i vogël.

Çmimet

Një gram kokainë që shitet më së shumti gjatë fundjavave kushton nga 80 deri 120 mijë lekë të vjetra. Për shkak të çmimit të lartë, kokaina është droga e të pasurve, dhe tregu i saj është i kufizuar. Edhe kapja e shpërndarësve të saj është më e vështirë për shkak të ruajtjes dhe kujdesit si të shpërndarësve dhe të përdoruesve. Ndërsa një gram heroinë në Tiranë shitet për 25 mijë lekë të vjetra.

Marijuana shitet nëpër gjimnaze

“Alliasi” dhe “Kinostudio” janë zonat më të nxehta në hartën e drogës në Tiranë. Në këto zona sipas policisë shpërndahet më shumë droga pavarësisht se përdoruesit vijnë nga zona të tjera. Gjithashtu marijuanë e heroinë shpërndahen edhe në Pub-e si dhe në shkollat e mesme të Tiranës. Jo pak herë policia ka arrestuar shpërndarës droge pranë shkollave të mesme në kryeqytet. Madje disa kohë më parë policia ngriti shërbime pranë këtyre shkollave me moton “Larg drogës nga shkolla”. Burimet policore thanë se gjimnazistët përdorin marijuanën gjë e cila sjell dhe shpërndarësit e kësaj droge disa metra larg gjimnazit. Të njëjtat burime shtuan se përdoruesve ua mban “xhepi” blerjen e drogës pasi një qese marijuanë kushton 5 mijë lekë të vjetra, ndërsa një dozë heroinë shkon deri në 10 mijë lekë të vjetra. E shtrenjtë dhe e papërballueshme është kokaina për shtresat e mesme e cila varion nga 70 deri në 100 mijë lekë të vjetra doza.

Historitë e përdoruesve të drogës

1 *****

“Ju rrëfej aventurat e hidhura që kur isha 10 vjeç”

E.D rrëfen aventurat e tij të frikshme dhe aspak zbavitëse që kur ishte ende fëmijë, dhe sot adoleshent, ku nën strehën e një të forti, jo vetëm do të mësonte të ishte përdorues droge, por shumë shpejt do të ushtronte edhe prostitucionin të ish gropa e famshme e Hajdin Sejdisë pranë Hotel Tiranës. Të paktën kështu pretendon. Por këto nuk kanë qenë të vetme problemet që ka pasur sepse dhuna fizike dhe psikologjike që uniformat blu kanë ushtruar mbi të kanë lënë edhe gjurmë mbi

trupin e tij, edhe pse kanë kaluar muaj e vite. 17-vjeçari E. D na kushton pak kohë pasi merr trajtimin me metadon pranë Aksion Plus dhe nis e rrëfen historinë e tij.

E.B: Punonjësi social i qendrës na tha se jeni një ndër tipat e veçantë të qendrës, dhe se keni plot histori?

Në fakt të vërtetën ka thënë. Shumë gjëra që kam kaluar janë disi të pabesueshme për moshën që kam pasur. Çamorrok kam qenë gjithnjë, por shpesh ama edhe e kam pësuar se jam përzier në lloj-lloj historish.

E.B: Na thoni ndonjë prej tyre?

Kam qenë vetëm 10 vjeç. Të gjithë djemtë e fortë të lagjes që ishin shumë më të rritur se unë më donin se isha vërtet i paparë, kështu më fushnin edhe në punët e tyre jo të mira.

Po kaloja afër gropës së Hajdin Sejdisë dhe pashë atë shokun tim që ishte më i rritur që po rrinte andej. Hajde të pimë ndonjë cigare më tha dhe vazhduam duke dredh cigaren. Po shikoja që ata homoseksualët po e thërrisnin këtë shokun tim. Kush janë këta e pyeta dhe çne me ata i thashë. Më tha se ata ishin njerëz që punonin për të dhe fitonte para nga ata. Madje më ftoi edhe mua që të merresha me ta, vetëm t'i vëzhgoja, dhe më pas t'u mblidhja lekët pasi shkonin me klientët. M'u duk punë me leverdi dhe fillova të punoj. Homoseksualëve i'u jepnim drogë, dhe me këtë ata mjaftoheshin.

Ky shoku më tha nëse kam ndonjë lek me vete me investu, dhe më pas të merrja më shumë. Po, kam i thashë 20 mijë lek të vjetra, por unë dua të fitoj - i thashë shokut tim, më shumë.

E.B: Po më pas çfarë ndodhi. Pyes sidomos në lidhje me drogën?

Deri atë ditë unë njihja vetëm hashashin, kurse heroinën nuk e kisha parë asnjëherë. Pasi e blemë diku, ia thashë këto shokut im: "pa hape njëherë ta shoh si është", ta paktën ta shihja. Po në fakt ky shoku im nuk donte që unë ta mësoja heroinën, apo të më bënte keq, dhe më thoshte që as të mos e provoja.

Kështu në fillim unë thjesht ja u dërgoja homoseksualëve te grupa që bënin seks, dhe vetë nuk e përdorja. Më vjen keq por nuk munda t'i rezistoj tundimit për ta provuar edhe vetë heroinën dhe kështu e fillova edhe unë. Kur shoku im e mori vesh që pija heroinë mbaj mend që më rrahu keq në mes të rrugës.

E.B: Po probleme me policinë ke pasur?

Kam qenë njëherë duke kaluar nga qendra dhe vjen një mallist me motor sepse i njihja pothuajse të gjithë mallistët. Më pëlqeu shumë motori dhe i kërkova të më bënte një xhiro. Ai më tha se mund të ma shiste shumë lirë dhe mua më pëlqenin shumë motorët dhe ende më pëlqejnë. Unë isha në punë atë kohë dhe i thashë për sa lek e ke mendjen ti, dhe më tha për 100 mijë lek të vjetra. Kështu më tha motorin dhe fillova të qarkulloja çdo ditë. Pas një jave më shohin ca djem dhe më ndalojnë në rrugë. Unë mendova se ata pëlqyen motorin tim dhe thashë mos po ja u ngeç për nja 400 -500 mijë lek. Njëri nga ata më tha se është motori i tij, por unë nuk i besova se mendova se po mashtronte. Ata djemtë më thanë t'u jepja motorin ose ta zgjidhnin me policinë këtë problem. Unë nuk po u besoja kështu erdhi policia. Ta dija se çfarë do më gjente do e lija motorin aty dhe do ikja në punën time.

E.B: Dhe në fakt çfarë ndodhi?

Policia erdhi për të ardhur, po unë jo vetëm që humba motorin, por na futën të gjithëve në furgon dhe gjithë kohës na qëllonin. Të zinjte e ullirit hoqa edhe kur erdhi i zoti i motorit dhe tregoi dokumentet e tij pastaj policia besoi se unë isha hajduti dhe shpirti im e di se çfarë hoqa nga rrahjet. U thashë se unë e kisha blerë atë motor, dhe më pas dolëm për të kërkuar ata që më kishte shitur por nuk e gjetëm dot. Kur u lodhën duke më rrahur më liruan. Ka pasur edhe plot rate të tjera që kam përfunduar nëpër rajone pa asnjë shkak. Mjafton të jesh përdorues dhe je në shënjestër të policisë për çdo gjë që ndodh. Madje jo vetëm në shënjestër, por nën tutelën e tyre. Këto shenjat që kam në trup i kam nga rrahjet që më kanë bërë.

E.B: Çfarë do bëni tani?

Ja tashmë po vazhdoj metadonin dhe ishalla e le këtë ves të poshtër. Po pres për të më dalë dokumentet për në Greqi, dhe të zhdukem nga ky llum i poshtër.

E.B: Ke vëlla apo motër?

Kam një vëlla më të vogël 1 vit se unë. Po ai nuk është si unë, nuk ka lidhje fare me mua. Është i mbarë, jo si unë që bëj zullume kudo që shkoj.

2 ****

“Në Greqi provova dhunën dhe poshtërimin se isha përdorues”

Përbuzjen dhe abuzimet në kurriz të tij i ka provuar në shtetin fqinj Greqi. Dhuna dhe poshtërimet që i kanë bërë policia greke për shkak se është përdorues droge kanë qenë të shpeshta sa nuk e mban mend as sa herë ka përfunduar në rajonet dhe burgjet greke. Tani A.C është 25 vjeç dhe është kthyer në Shqipëri për të filluar trajtimin me metadon sepse shteti fqinj nuk ia dha as këtë të drejtë.

E.B: Sa vjeç jeni?

Para dy muajsh mbusha 25 vjeç.

E.B: Mund të më tregosh si e fillove për herë të parë rrugën e drogës?

Kam qenë 16 vjeç dhe në fillim e mësove me shoqërinë. Filluam me hashash, por shumë shpejt do të përfundoja në kokainë.

E.B: Ishte thjesht kuriozitet, apo shoqëria juaj këmbënguli që t'i futeshit kësaj rruge?

Jetoja në Greqi pasi kam rreth 20 vjet që jetoj me familjen andej dhe këtu jemi kthyer këtë vit. Atje kisha shoqëri, shqiptarë dhe grekë. Filluam eksperimentet me vesin, e tashmë kam 9 vjet që jetoj me këtë helm.

E.B: Keni tentuar për ta lënë ndonjëherë?

Shumë herë kam tentuar. Kur isha në Greqi doja të futesha në një qendër rehabilitimi për përdoruesit e drogës, por nuk ma mundësuan këtë sepse isha shqiptar dhe për ata prioritet janë grekët. Tani që kam ardhur në Shqipëri jam futur tek “Aksion Plus” për tu trajtuar me metadon.

E.B: Thatë se në Greqi nuk ju futën në qendrën e rehabilitimit për përdoruesit e drogës sepse ishit shqiptar, por me drejtësinë greke keni pasur probleme?

Është më mirë të mos m’i kujtosh. Kam vuajtur shumë për faktin se isha shqiptar, dhe aq më keq edhe përdorues droge.

E.B: Mund të na thoni diçka më shumë për këto vuajtje?

Policia na arrestonte pa asnjë shkak vetëm se ishim përdorues. Më kanë mbajtur shumë herë me ditë të tëra në paraburgim. Sa për torturat ishin vërtet të rënda me rrahje me shkopinj gome, paraburgim pa kushte minimale dhe fyerje nga më të ndryshmet. Më kanë arrestuar plot gjashtë herë dhe më kanë trajtuar me të njëjta mënyra. Ne shqiptarëve sidomos na trajtonin shumë keq duke abuzuar në të gjitha mënyrat në kurrizin tonë.

E.B: Kërkuat ndonjëherë avokat për të ndjekur të drejtat tuaja?

Në Greqi asnjëherë. Nuk e gjen kurrë të drejtën atje ndaj dhe nuk u mundova kurrë.

E.B: Po tani çfarë keni në plan të bëni?

Tani siç ju thashë jam futur në trajtimin e metadonit dhe shpresoj që të heq dorë njëherë e përgjithmonë nga vesi që më shkatërroi jetën.

3 ****

“Nëse je përdorues për policinë je gjithnjë fajtor”

E.B: Përshëndeje! Mund të realizojmë një intervistë të shkurtër?

Sigurisht. Nëse ju nuk publikoni as emrin dhe asnjë të dhënë që mund të më identifikoni?

E.B: Mund të më thuash sa vjeç jeni?

Jam 24 vjeç.

E.B: Kur filluat për herë të parë të jeni përdorues droge?

Që 14 vjeç kam përdorur hashash, dhe vetëm një vit më pas kalova direkt në heroinë. Kjo e fundit më shkatërroi plotësisht.

E.B: Mbani mend si ratë pre e drogës?

Ju thashë se isha 14 vjeç kur pija rregullisht hashash. E fillova me shoqërinë, ashtu grup çunash. Pa e kuptuar fare fillova të provoj edhe heroinë dhe u bëra vartës i saj. Ishim një grup prej 7-8 djemsh që rrinim gjithmonë bashkë dhe konsumonim mall. Na u bë pjesë e jetës dhe nuk mendonim për asgjë tjetër, vetëm si të siguronim mallin.

E.B: Si e siguronit drogën?

Në forma të ndryshme dhe aspak të këndshme. Madje mund të them se e siguronim drogën në rrugë shumë të gabuara aq sa as nuk mund të mendohen.

E.B: Po çfarë bënit konkretisht?

Kur nuk na dilte ndonjë punë e rastit detyroheshim të vidhnim në shtëpi apo të bënin edhe ndonjë pisllek tjetër. Kur je një përdorues droge pak rëndësi kanë gjërat e tjera, e rëndësishme është të sigurosh drogën, dhe jo rrugët se si e siguron.

E.B: Ju duket e drejtë kjo?

Ju apo çdokush mund të gjykoni për këtë, por uroj të mos e shohë veten askush nën kthetrat e drogës ndryshe “padroni komandues” do jetë helmi i bardhë, dhe ky i fundit vendos për gjithçka.

E.B: Thatë se e keni siguruar drogën në mënyra të ndryshme madje edhe duke vjedhur po me drejtësinë keni pasur probleme?

Duhet të dini se kur je përdorues droge je personi më i pabesueshëm se gjithkush. E pranoj se unë, por edhe shumë përdorues të tjerë kanë bërë gjëra të papëlqyeshme për të siguruar atë drej helmi, por duhet të dini se shpesh jemi ndjerë të abuzuar nga policia, edhe me pa të drejtë. Nëse je i etiketuar se je përdorues droge për policinë je hajdut, kriminel, ordiner dhe çdo gjë tjetër.

E.B: Po mund të na thoni ndonjë formë abuzimi nga policia?

Mund të jem futur me dhjetra herë nëpër rajone policie pa asnjë shkak. Madje nuk më kanë kapur as me sasi të vogël që është për përdorues. Na marrin gjoja për sqarime dhe nuk na i kursejnë të rrahurat. Kjo ndodh rëndom nga policia dhe shpresojmë që kjo situatë të marrë fund.

Mbaj mend një herë kur më kishin mbyllur në qeli, për pak sa nuk po më merrej fryma sepse nuk kishte as dritare apo ndonje vrimë nga ku të merrje ajër. U afrova pranë dyshemesë, te fundi i derës së qelisë për të thithuar sado pak ajër që mund të futej prej aty. Askush nuk e vret mendjen nëse ke frikë nga mjediset e mbyllura, dhe se nga ankthi mund të tentosh vetëvrasjen.

E.B: Po tani çfarë keni ndërmend të bëni?

Jam futur në trajtimin me metadon. Shpresoj të gjej forcë dhe ta lë sepse droga po më shkatërron përfundimisht.

4 ****

“Lexoni historinë e jetës time, ja përse tentova të djeg trupin tim”

Një ditë shtatori, ngjarja e rëndë tronditi kryeqytetin. Disi e paimagjinueshme por një i ri 27 vjeçar tentoi t'i vinte flakën vetes pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë. Aludimet nga policia, mediat dhe strukturat e tjera ishin nga më të ndryshmet por të vërtetën e historisë mund ta rrëfejë vetëm personazhi. Ai është përdorues droge, prej 13 vjetësh, ka kaluar çdo vështirësi dhe më mirë se ai nuk mund të rrëfejë askush tjetër botën e hidhur dhe të ashpër të drogës. Vendosëm të mos i bëjmë asnjë pyetje, por të thotë gjithçka ndjen dhe përjeton

Nuk e di se nga t'ia filloj, por po mundohem të gjej fillin dhe të rrëfej. Tani jam 27-vjeçar kurse atëherë kam qenë 14-vjeç, a diçka me tepër. Pothuajse gjysmën e jetës e kam kaluar në këtë mënyrë ose si do t'i thosha dikujt si puna ime (ashtu siç flasim ne me zhargonin e rrugës) “na iku jeta prej shalësh”, ose për të qenë pak më i saktë e shpërdorua, e çuam dëm; diçka që një herë të vetme të vjen ne jetë, por që është pak më e veçantë se pjesët e tjera të jetës. Adoleshencën, kulmin e rinisë, majën e ajsbergut të jetës. Atë fazë ku si një fëmijë nuk je marioneta e prindërve të tu, as prindi i fëmijëve të tu (i atyre që të bëjnë të ndihesh përgjegjës për shumë gjëra, qoftë edhe për të jetuar, do apo s'do ti). Ky është realiteti, nuk pranon që ta shohësh në sy. Jam mëse real kur them se jam i vetëdijshëm se tjetër gjë është një *spinel* në një festë, dhe është komplet tjetër gjë të kesh kaluar për 14-vjet përdorues i lëndëve narkotike, kryesisht heroinës. Droga që në mënyrë direkte apo indirekte është shkaktarja kryesore e vdekjes së shume të rinjve. Gjithashtu më duhet të pohoj se është P.O.S (The poëer of subjections) fuqia që si një placebo i bën sinapsit të trupit të çdo njeriu të jetë për një kohë në një gjendje ku as vete nuk është i aftë të kuptojë se nuk është ky realiteti. Pavarësisht se do të doje t'i që të ishte kështu. Mirë se erdhët në “Nirvana”, aty ku e kaluara e tashmja dhe e ardhmja lundrojnë me njëra-tjetrën. Uroj për ju që të arrij t'ju them dhe mirupafshim, të jeni dikush që do të ketë fatin t'i lexojë këto fjalë. Jo sepse do të ndihet mirë që ka në dorë këtë libër por sepse nuk është një nga ata që nuk e patën këtë mundësi. Jo se nuk deshën, e kam fjalën për ata yje që u shuan prej zjarrit të vet. Ishte fati i tyre i keq që te mos jetojnë më, qoftë edhe në këtë botë të fëlliqur, ku edhe për vdekjen e tyre nuk do të ketë asnjë fajtor. Vetëm një fjalë... dhe ç'do gjë mbaron këtu për të mos filluar kurrë më... MBIDOZE.

Nuk dua t'ju flas për ato që nuk i di. Pse linda atje ku linda, përse linda ky që jam, përse më quajnë ashtu si të tjerë menduan të më vënë emrin? Do ju flas për atë që unë mendoj se kam dashur të bëj, vetëm se dua që më parë t'ju them këtë gjë: “Të gjithë ne jemi viktimat e paevitueshme të së kaluarës tonë”. Një ditë që nuk e mbaj mend, por që kurrë nuk do ta harroj. Isha me katër shokët e mi, S, E, E, dhe më i vogli prej nesh J (që ne e thërrasim L, kurse ne të dy tani nuk flasim edhe pse ai dhe unë jemi të vetmit që e vazhduam këtë rrugë). Arsyeja e njohjes dhe e ndarjes tonë ishte D, shoqja ime e bankës, vajza më e bukur e klasës. Dashuria ime e parë, një dashuri e pamundur, e

ekzistuar për të ngelur thjesht një dashuri platonike. Më është dashur t'i mposht ndjenjat e mia për të ruajtur kodin tim të nderit, si rrjedhojë askush tjetër nuk mund të më bëjë me faj për këtë gjë.

Ishte pasdite vonë, erdhi një djalë rrugaç, siç mund t'i thoshin ne atë kohë D, dhe na tha që të shkonim me të. Na çoi në një shtëpi të braktisur aty afër. Kur u futëm brenda ai nxori diçka që e kishte fshehur, jo pak por gjysëm kg hashash. Ai na tha se nuk e mbante dot vetëm, nuk i shijonte a diçka të tillë. Por unë nuk bëra si shokët e mi që nuk e thithnin tymin. S'e mbaj mend se si jam ndjerë, as ç'farë ishte ajo që më shtynte ta bëja atë gjë, por për herë të parë në jetën time piva një cigare hashash. Që të nesërmen filluam të gjithë cigaren, pasi kur dolëm atë natë ikëm të gjithë për në shtëpi pasi ishte errësuar. Nga ajo ditë nuk ndryshoi shumë jeta ime në dukje, por si "Dr. Jackie" (film i famshëm) diçka filloi të ndryshojë brenda meje. Pas disa zënkash adoleshentësh, fillova të rri me disa shokë të tjerë, por që vazhdoja të bëja të njëjtat gjëra. Çdo ditë doja vetëm një gjë, të dehesh... alkool, kanabis, më vonë dhe heroinë.

Kisha ngelur në gjimnaz në vitin e dytë në katër lëndë. Edhe njëherë nëna natyrë ma dha goditjen e vetë. S'e di tani po në atë kohë në klasën time nuk dinin të shkruanin as emrin e vet, dhe i vetmi që ngela isha unë. Nuk më interesonte shkolla, ose nuk i mbaja mend më fjalët (mami, babi, unë...) Në atë kohë mendoja se ç'do gjë në jetë do më duhej të bëja vetë por si... Ëndrra Amerikane brenda të gjithë neve është pothuajse njësoj. Për një adoleshent është e lehtë të bëhet një adhurues i Toni Montana-ve, më mirë se sa të pranoj se heroi i vërtetë është se ai që ç'do ditë ngrihet në mëngjes për të shkuar në punën që i siguron jetesën atij dhe familjes së vet. Jo të gjithë mund të jenë numri një, jo sepse jam unë një dështak që është dorëzuar, por të tjera gjëra doja dhe të tjera bëja. Sepse kur kam qenë 17 vjeç shkuam te një shoku im mbas gjimnazit. Takuam aty dy shokët e tij të klasës. V që po rrinte aty me të dashurën, dhe I, që vjet doli nga burgu pasi bëri disa vite për shitje lëndësh narkotike. Kurse V dhe e dashura e tij tani kanë një djalë 5 vjeç, por pasi bëri disa muaj brenda, tani ra përsëri në burg për të njëjtën gjë (vjedhje makine). Tani ka ardhur koha që të gjithë e kanë kuptuar që të shesësh drogë ose duhet të jesh spiun, ose duhet të paguash. Gjë kjo që përjashtohet për peshqit e vegjël. Por si shokë që na kishte, V na qerasi që të treve (sepse shiste, kurse ne nuk folëm fare për lekë). Nuk folëm për asgjë edhe pse për të tre ne ishte hera e parë asnjë nuk hezitoi (një mënyrë tjetër për t'u dehur), një vizë dhe pak tym më foli (duke e djegur mbi letër alumini). Më pas pimë kafe dhe më vone për ta mbyllur me aq sa kisha unë dhe shokët e mi vajtëm në pub. Nuk mund ta mohoj se atë ditë nuk u kënaqa, as kur piva për herë të parë me L, pasi ia blemë V kokainën. Por qejfi paguhet, dhe nuk janë të gjithë djem e vajza milionerësh.

Do më falni nëse i referohem amendamentit të 5 të Kushtetutës Amerikane që më lejon të mos flas për gjëra që do më auto-inkriminonin edhe pse do të ruhet anonimatimi im. Sa për ligje e drejtësi jam lodhur shumë tani për të shpresuar më. Edhe unë siç do njeri, pak nga pak çdo ditë e më shumë mendoj vetëm për të shpëtuar lëkurën derisa të kapim moshën e pensionit. Kam njohur boll njerëz që donin vetëm sa të hapnin një bar. Edhe po të jetonin akoma s'besoj se do e kishin hapur, thjesht i kam kursyer vetes zhgënjimin. Kështu vini pak në punë imagjinatën tuaj, se si kam pirë për 11 vjet heroinë dhe droga të tjera. Po ju them se vetëm pas një jete të shturur për herë të parë në jetën time, në moshën 22 vjeç rashë në burg për 7 muaj. Si hera e parë që ishte familja më ndihmoi (sepse përndryshe gjërat nuk do të kishin vajtur në atë mënyrë). Por pasi dola këtu ika me G, në Greqi për të rënë përsëri pas vetëm 20 ditësh, po për të njëjtën gjë, për vjedhje makine (kësaj radhe pa armëmbajtje). Sa kishim shkuar në Lutraqi (afër Athinës) te motra e V, takuam anës plazhit një djalë të ri që po pinte një cigare hashashi. Vajtëm ta pinim me të, dhe ai na kërkoi të blinte nga ne kur e

mori vesh se ishim nga Fieri, ç'farë të donim ne, hashash, heroinë dhe si përfundim një Subaru të vjedhur. Kishim vetëm 4 ditë aty, por 5 mijë eurot që na ofroi na bënë punë edhe atë që donte ai mund t'ia gjenim. Që t'i bie shkurt kur ia çuam e pamë që ishte një kurth. Na kapën në urën Korintho-Lutraki, (e kujt po i plaste në ato momente për tre muaj e gjysëm që bëra). Për pak desh vajtëm t'i shisnim drogë një polici në Greqi, ku shqiptarët dënohen 10 vjet vetëm për një peshore. Kurse ai donte vetëm të merrte një gradë. Do kishim qenë dy idiotët më të mëdhenj në burgjet e Greqisë.

Të gjithë e dinë që ka edhe njerëz të paskrupullt, qoftë ky edhe polic, pavarësisht se kam edhe njerëzit e mi të tillë, për mos të thënë që unë jam delja e zezë në fisin tim (si shumë përdorues n.q.s nuk vijnë nga familje të degraduara). Edhe pse akoma nuk më lejohet të shkoj në B.E, nuk ndenja shumë në shtëpi. Përsëri ilegal, me drogën isha mësuar tashmë... Abstinencë... Fillova të pi vetëm të shtunave duke u gdhirë e diel në ndonjë Klub striptizmi, dhe më pas edhe ndonjë dritë e kuqe. Pastaj erdhi A (Liza ime në botën e çudirave). Moshën s'po ju a them, po jam i bindur se ç'do mashkull funksional do linte kokën pas saj. Ishim të rinj, kishim lekë, dhe të dy donim vetëm një gjë... seks, droge dhe muzike. Pasi kaluam 5 a 6 muaj bashkë, një familje e pasur si e asaj nuk mund të linte në shkollë atë super seksi të flinte mbi bankë në klasë. Kështu ngela përsëri vetëm për momentin, rastisi që të më kape dhe policia, por pas 2 javësh në shtëpi ika prapë në Athinë. Kisha filluar të mësohesha me jetën atje pasi kam ndenjtur për 3-4 vjet aty. Do më duheshin dhe nja 3 muaj burg që të pranoj realitetin. Nuk kishte vend për mua aty. Nuk është fare e vështirë për t'u kuptuar. Me ligjin e famshëm që i lejon përdoruesit të mbajnë deri në 0.8 gram me vete, dhe që fillon nga 5 vjet minimalisht. Nejtë, këto mekanizma legjislative që janë krijuar për të gjetur qoftë dhe një herë të vetme gabim (kujt nuk i ka ndodhur të ketë një motiv për të mbajtur 0.9 gram me vete, një festë, marrja e rrogës së shumëpritur, apo arsyeja më banale marrja e një dhurate prej atij që ta shet) kurse tani që policët ishin kthyer nga plazhi pse mos të bënin një raprezalje ku doemos do ngecte brenda rrjetës dikush.

Nuk po flas për të tjerët atë ditë sepse e vërteta doli pas pak orësh brenda rrethit, por sepse n.q.s do ta bëja publikisht do isha dhe unë asnjë gjë tjetër veçse një spiun. Do them vetëm diçka për vete, për mua që e kisha gjyshen dhe gjysmën e fisit në spital ato ditë, që pija 60 gram metadon në ditë. Kisha kursyer 20 a 30 miligram nga të dielave që e pija në shtëpi dhe nja 10 kokrra heptanon, i njëjti ilaç pothuajse i marrë dhe ky me raport të rregullt nga spitali. Kaq mjaftonin për të çuar një xhiro në rajonin e policisë sikur do më çonin në gjyq për ato. Edhe kjo punë, dhe pastaj u zgjidhën hallet edhe shtetit shqiptar. Aty s'po e them me detaje se si ndodhi, gjithmonë gjërat ndryshojnë për çdo klient. Është aty ligji dhe Maliqi njëkohësisht, vetëm një gjë nuk ka ndryshuar kurrë... dhuna fizike dhe psikologjike. Polici i mirë, polici i keq, pastaj prapë ai i mirë, edhe pse kjo është një specie e zhdukur me dinosaurët. Për ta është vetëm një lojë teatrale derisa të marrin deklaratën e famshme që do bashkëpunosh me vullnetin tënd të plotë me ta. Se, ku është parë ndonjë të dale me dëshirë të madhe për t'i ndihmuar këta të marrin fitimet e punës së tyre. Edhe kjo një tjetër punë ligjesh. Dola që aty duke bërë një gabim, por nuk mund të bëja tjetër, veçse më duhej të ruaja kokën. Dikush duhej kapur brenda katër a pesë ditësh, ose për të qenë më i saktë disa; në asnjë mënyrë nuk duhej të pushonin së shiture, përndryshe, ai që do të përfundoja keq isha unë. Ashtu si T. një djalë tjetër përdorues, ose ish. E njëjta histori, të njëjtët djem shitës (kaq shumë të rrezikshëm, të superkërkuar, sikur të ishin të vetmit në Tiranë). I njëjti polic... vetëm se ai pati pak më shumë kohë, ai zgjodhi një fund tjetër, në vend të disa vjetëve burg pa mbushur një muaj, I tha hapur terminatorit të antidrogës “mos më telefono më se na çave trapin” dhe përfundoi për vjedhje për të dalë për disa muaj, nëse do

të ishte me fat, gjë që dyshoj shumë. Ashtu siç bota dyshon, se ne jemi viktimë në këtë mes, ashtu si do dyshonte edhe familja ime sadopak. Nuk jam unë, që kam komplekse komunikimi, preferoj t'i zgjidh vetë punët e mia. Besoj se me kaq e kam shpjeguar përse. Puna ishte si t'ja bëja unë që K.K dhe B.R, për katër ditë të kapnin dy, tre a pesë vetë, gjë që ishte e pamundur për mua. Besojeni ose jo, nuk ja kam futur njeriu deri më sot, që nuk e ka merituar. Por ai që e meritonte ishte K, një polic që lejoi "Gestapot" e tij të më "përgatisnin" për tek ai, që nuk i bëhej vone se çdo të ndodhte me mua dhe familjen time pas "punës", që më detyronte të merrja drogë përditë (gjë që dënohej nga i njëjti ligj). Faktikisht një njeri i tillë duhet të jetonte në *Far Ëest*, që të merrte atë që meritonte. Për asnjë arsye nuk e shmang një burgim të përjetshëm, për të bërë atë që do kishin dashur të gjithë në vendin tim.

Kështu ndodhesha në mes të rrugës plot me dilema në kokën time. Çfarë mund të beja unë kur më kërkoheshin gjëra të tilla të padrejta? Po të isha kapur i pirë ose duke pirë, ose para se të pija, qoftë edhe me një mbidozë, do kisha marrë përgjegjësitë e mija. Por isha i future në një kurth të padrejtë, i stresuar, i revoltuar dhe me gjithë atë depresion ndjehesha i braktisur. E vetmja gjë që pashë, ishte se ata i kishin duart e lira. Çfarëdo lloj gjëje që preket nën mbrojtjen e shtetit qoftë ky një xham i thyer i një institucioni shtetëror, qoftë një funksionar i lartë çfarëdo grade të ketë, është një mision i pamundur. Vetëm se pas shumë shpërthimeve nervash vendosa që thjesht t'i demaskoja ata, dhe kështu të paktën mund të shpëtoja pastaj, se çfarë do të ndodhte dihet ose të paktën kuptohet. Por, te pretendosh se këtu çdo gjë është e pa aftë të gjesh ndihmë në ndonjë media edhe pse quhet pushteti i 4-rt, komplet fallco. Ndodh që njeriu kur ndodhet në vështirësi të besojë edhe në një mrekulli të Fiks Fare. Por vajtja atje, edhe andej-këndej thjesht sa më vonoi, dhe e gjeta veten një ditë në mëngjes me gjithë hallet dhe problemet e përditshme që mund të ketë çdo njëri (të dy prindërit, si dhe unë vetë, gjithashtu i papunë, një gjyshe të shtruar në spital ato ditë ashtu si dhe vetë një i sëmurë kronik., të paktën në botë kështu quhet një toksikodipendent). Dhe sikur të mos mjaftonin të paktën vetëm këto sa thashë (ka akoma po them se këto mjaftojnë) kisha një polic së bashku me disa kolege të tij që më prisnin mua për të bërë punën. Unë kisha bërë vetëm atë që më kishte detyruar ta bëja: i kisha thënë gjithmonë vetes po. I gjendur me shpatulla pas murit më duhet të mendoja për një zgjidhje gjë që ashtu si ndihesha e pata të pamundur të bëj. S'e di por në atë çast, mbase meqë nuk e kisha folur me asnjë njeri, do të doja t'ia thoja të gjithëve. Por si?! Si ta ktheja botën të shihte pas atij që kishte nevojë? Provova edhe njëherë për të thirrur median, kësaj radhe për të kërcënuar me vetëvrasje, për shkak të anonimatit më duhet të shmang detajet). Por nuk duhet të presësh shumë nga këta papagaj të politikave. Këta janë si hiena që kënaqen vetëm me kufoma të braktisura. E vërtetova pasi u mbyll kjo punë me eprorët e atyre "Gestapove". Mua më thanë se do të më linin rehat (le të shpresojmë!) kurse unë do të vazhdoj të ruaj thirrjet telefonike dhe mesazhin kërcënues të dërguar pikërisht gjatë "Harakirit". Meqë kështu e lexova në disa gazeta të ndjekur nga artikuj që më shumë se gazetareske dukeshin si të publikuar nga ndonjë fallxhore. E çfarë të bëja më shumë? Njerëz të ndryshëm më kanë thënë gjëra të ndryshme. Të hiqja dikë nga puna sikur në vend të tij nuk do vinte një tjetër i tillë. Të kërkjoja lekë, sikur ta dija sesa vlen jeta ime. Kam dëgjuar vetëm absurditete të tilla, sepse askush s'e di të më thotë se si mund të kesh drejtësi në këtë botë. Të paktën këtu ku jetojmë ne, harrojeni.

Të gjithë mendojmë të shpëtojmë kokën derisa të arrijmë pensionin. Sa për vete, them se do më duhet të vazhdoj të mbaj vendimin që mora para pak kohësh. Edhe pse nuk kanë kaluar shumë ditë them se nuk ka rëndësi koha e kaluar. Them se duhet të shohim të kaluarën si një mësim ndaj vetes. Sa për të tjerët, edhe pse nuk jam shumë egoist, them se nuk mund të flas për jetët që nuk i kam

njohur. Edhe n.q.s po e lexoni këtë mos mendoni se e njihni jetën time, ajo fillon që ditën që linda. Kjo ishte vetëm historia ime, mendova ta shkruaj meqë përfundoi. Nuk ka më viza të bardha, të kuqe, cigare për të tymosur dhe për më tepër “injeksion-vdekje”. Ndoshta jeta për mua ka rezervuar shumë ditë në vazhdim, shpresoj të mbetem ky që jam. Të mbeten ditët e mija ditët e drogës, ditët e një historie ku nuk mund të shkruaj as emrin tim po veçse dhimbje e padrejtësi. Unë pavarësisht mënyrës, e gjeta një derë për të dalë prej atij rrethi. Them se po... kanë kaluar pak ditë dhe po filloj të ndjej shumë ndryshime. Mbase gjërat nuk do të jenë kështu gjithmonë, ndoshta më mirë... ndoshta më keq... gjithsesi nuk e di se për çfarë do jetoj në jetën time, nuk e di se për kë, di se nuk do jetoj më për ato që tregova deri tani. Di se jam me fat, pavarësisht atyre që më kanë ndodhur të paktën jam ende gjallë, nuk jam një nga ata që vdiqën pa një fajtor. Vetëm një fjalë... MBIDOZE... Unë dola prej atij rrethi.

5 ****

Dëshmia, si rashë pre e drogës që 15 vjeç

Vartësi i drogës, M.D., nga Durrësi tregon historinë e tij. Si shkatërrova jetën time dhe të prindërve.

Fytyrë e verdhë dhe trup që mbahet në një skelet të gjatë prej kockash, i cili dridhet si një gjethe peme që është duke rënë. Ndërsa zërin e ka aq të ulët, sa duhet ta pyesësh më shumë se 2 herë për të dëgjuar se çfarë thotë. Madje droga e ka katandisur deri në atë pikë sa edhe sytë i janë mbuluar nga rrema gjaku të kuq, aq sa është vështirë t’ia dallosh ngjyrën e kaltër. M.D., është 22 vjeç dhe ka nisur të jetë përdorues i drogave që kur ishte 15 vjeç e tashmë duket se e ka të pamundur të ndahet nga droga. Duke pranuar të tregojë historinë e tij tek Qendra “Aksion Plus” dhe të japë një mesazh për të gjithë bashkëmoshatarët e tij, ai thekson se droga është e keqja më e madhe që mund t’i ndodhë një personi.

E.B: Sa vjeç jeni dhe kur keni filluar të përdorni drogë për herë të parë?

Jam 22 vjeç dhe drogën e fillova kur isha vetëm 15 vjeç. Në fillim e nisa me hashash, por pas një viti kalova në heroinë.

E.B: Cila ishte arsyeja që vendosët të përdorni drogë?

Ishte kurioziteti, kur e mora për herë të parë. Por shumë shpejt u bëra vartës, sidomos kur fillova heroinën.

E.B: A ishte e vështirë për t’i siguruar këto lëndë?

Sa më shumë e përdor, më e vështirë bëhet. Çmimet çdo ditë po rriten. Policia po gjurmon spaçatorët (shpërndarësit) dhe arsyeja tjetër është se nuk po siguroj dot lekët. Nëse kur isha 15 vjeç u thoja atyre të shtëpisë se më duhen 5 mijë lekë se do ha picë me shoqërinë, tashmë, ata e dinë se unë marr drogë e këto gënjeshtër nuk më ecin më.

E.B: Kur vendosët të linit drogën?

Këtë e vendosa para 3 vitesh, kur më vdiq edhe babai. E kuptova shumë mirë hallin që kishte zënë familjen dhe mua. Jam penduar shumë e nuk kam më forcë t'iu kërkoi ndjesë njerëzve të mi të cilëve u shkatërrova jetën.

E.B: Në momentin që nuk keni mundur të siguroni paratë për drogën, si ia kenë bërë?

Unë personalisht, kam arritur që t'ia dal duke e marrë kokainën në Durrës pak më lirë dhe duke e shitur në Tiranë pak më shtrenjtë. Me paratë që fitoja, blija drogën për ta përdorur vetë.

E.B: Kjo do të thotë se ju keni bërë edhe rolin e shpërndarësit të drogës. Policia, ju ka ngacmuar ndonjëherë?

Jo, unë asnjëherë nuk kam pasur probleme me policinë. Kam shumë shokë që janë aktualisht në burg. Ndoshta unë kam shpëtuar disa herë, pasi jam edhe me studime në Itali dhe zhdukem sa andej-këtej. Të gjithë shokët e mi e kanë nga një eksperiencë me policinë.

E.B: Cili është mesazhi që do t'i përcillni moshatarëve të tu?

Rrini sa më larg drogës. Ajo shkatërroi jetën time dhe të prindërve të mi. Nëse bëhesh vartës i saj, mendo se je drejt fundit, dhe është pothuajse e pamundur për t'u kthyer pas.

6 *****

“Droga më shkatërroi familjen, më detyroi të vjedh”.

Një përdorues i lëndëve narkotike, rrëfen, historinë e nisjes së konsumimit të drogës, burgun dhe divorcin me të shoqen

"Me të u njoha në burg. Kur ajo mësoi se unë merrja bar u largua dhe mori me vete edhe djalin të cilin nuk e shoh prej tre muajsh"

Sot ai është 43 vjeç, drogën e ka nisur që kur ishte 28 vjeç. Quhet B. D, jeton i vetëm nuk ka një banesë ku të strehohet, nga kjo detyrohet të flejë jashtë jo rrallë herë. Konsumimin e lëndës narkotike e ka nisur thujse si të gjithë të tjerët duke rënë pa dashur në grackën e parajsës që të ofron.

Kjo ka ndodhur këtu e 15 vite të shkuara në kryeqytet, kur B. D, braktisi vendlindjen e tij Beratin për të jetuar në Tiranë. Që nga ajo kohë, është martuar dhe divorcuar me bashkëshorten por me pluhurin e bardhë, nuk ka mundur të "divorcohet".

Me bashkëshorten që e njohu në burgun 313, është ndarë prej gati katër muajsh, por shpreson që një ditë, madje edhe së afërmi të jetojë me të dhe djalin e tij që sot është një vjeç.

Në një rrëfim mbi jetën nën ndikimin e heroinës, kokainës dhe marijuanës, 43 vjeçari rrëfen çastet e para, shijen dhe rrugën për të siguruar mallin, madje jo pak herë për mes rrugës së gabuar që ai e pranon, vjedhjes së të tjerëve.

E.B: Kush jeni?

Quhem B. D dhe jam 43 vjeç, jetoj në Tiranë prej shumë vitesh. Jam i divorcuar dhe kam një djalë me të cilin shpresoj të ribashkohem.

E.B: Sa vjet ka që përdorni drogë? Çfarë lloje droge ke përdorur?

Drogën e kam filluar që në vitin 1994 dhe vazhdoj ta përdor dhe sot. Kam përdorur thuajse të gjitha llojet: si marijuanë, heroinë, hashash dhe më parë e pija me cigare, pastaj fillova ta marr me të djegur dhe në fund me shiringë.

E.B: Sa kushton gram i secilës

25- 30 mijë lekë.

E.B: Si nisët ta merrnit drogën?

Pasi erdha në Tiranë nga Berati, u takova me një shoqëri që përdorte drogë dhe vazhdimisht fillova të frekuentoja një lokal tek Parku Rinia, që sot nuk është më. Ishte viti 1994, aty takoja shpesh ca të rinj që pinin hashash.

Një ditë, data nuk më kujtohet, më kërkoi njëri një cigare. I thashë se çfarë e donte, ndërsa ai më tha do pi pak "kallo", një term që përdorej për hashashin që mos ta dëgjonin të tjerët. Ia dhashë cigaren dhe ai më ofroi një cigare gjithashtu dhe e mora.

Brenda saj kishte patur heroinë. Pasi e konsumova cigaren për pak minuta isha si në një gjendje gjumi dhe ndihesha i çliruar në vetvete. Më vonë nisa të bashkohem me dy tre përdorues të tjerë dhe mbledhëm lekët që kishim dhe blinim hashash.

Nga kjo kohë dhe në vazhdim unë nuk e kam ndërprerë marrjen e drogës. Ky është çasti që kam marrë drogë për herë të parë. Ishte kjo rastësi që më pas më ktheu në një përdorues droge.

E.B: Në çfarë mënyre e gjen drogën? Në cilat zona të Tiranës ka më shumë?

Për ta gjetur nuk është aspak e vështirë. Mjafton ta porosis tek një shok dhe shumë shpejt gjendet. Vështirësia më e madhe është tek mungesa e lekëve. Kur nuk ke lekë, atëherë do të detyrohesh të vjedhësh apo të bësh ndonjë punë apo dhe të mbledhësh kanoçe, gjëra që unë i kam bërë gjatë këtyre viteve.

Droga gjendet kollaj. Tek "Parku Rinia" gjen sa të duash, gjithashtu dhe tek "21 dhjetori" apo dhe në ish-Blok, tek rruga e Elbasani, tek rruga e Kavajës. Mund të them se drogën e pijnë si të varfrit, ashtu dhe të pasurit. Njëri e merr si lojë, tjetri e pi nga qefji, dhe kështu më pas kthehen në përdorues të zakonshëm.

E.B: Si i gjeni lekët për të blerë drogë?

Më shumë më ndihmojnë vëllezërit, më japin lekë. Ata nuk është se mi japin lekët për drogë, pasi unë e përdor fshehurazi, por ato lekët që më japin i përdor për të blerë pluhurin.

Por edhe vetë kam punuar në disa raste, madje duke mbledhur dhe kanoçe. Ndërsa në momentet që nuk kam patur asnjë qindarkë, jam detyruar të vjedh. Ka patur shumë raste që iu kam vjedhur celularin njerëzve në rrugë apo kam thyer dyqane.

Vjedhjet isha i detyruar t'i bëja, vetëm për të siguruar lekët për drogë dhe për asgjë tjetër. Por për ketë e kam paguar shtrenjtë, pasi kam përfunduar dhe në burg disa herë, ku kam qëndruar dhe dy vjet në qeli.

E.B: Po në burg ke përdorur drogë?

Si jashtë, jo. Kisha pak mundësi ta përdorja, se aty kishte kontrolle të rrepta, por nuk është se nuk e kam përdorur fare. Pra asgjë nuk është e pamundur as në burg. Mjafton të shpërblesh ata që ta sjellin, dhe nuk ka si të mungojë as në burg droga.

E.B: Si e konsumon drogën tani. Në çfarë mase e merr?

Mund të pi një herë në tre ditë, gjysmë grami, ngaqë kam kriza të vazhdueshme. Zakonisht e marr me hundë se nuk kam më vend në trup ku të shpohem.

E.B: Ke marrë vendim për ta lënë. Çfarë do të bëni në vazhdim?

Unë kam dashur ta lija me kohë, por nuk kam mundur për shumë arsye. Tani kam marrë një vendim për ta lënë dhe do të vij duke e reduktuar sasinë që pi. Dua të filloj një jetë të re, se droga ishte ajo që më shkatërroi familjen.

Shoqëria na paragjykon ne përdoruesve të drogës, por dhe në familje paragjykohe dhe gjej qetësi tek droga. Do përpiqem të jem si gjithë të tjerët, të gjej një punë dhe të jetoj bashkë me familjen time.

E.B: Keni shoqëri? Njihni vetëm persona që drogohen apo dhe të tjerë?

Shoqëri kam nga të dy kategoritë, si të droguar ashtu dhe shokë të pa droguar. Kur vjen momenti që duhet të marr drogë, largohem pa dijeninë e tyre, por kur ata shokë që nuk e përdorin më kritikojnë vazhdimisht që unë të heq dorë.

Madje më thonë që tani që je baba, duhet të mos e përdorësh më. Me të droguarit ndodh e kundërta. Ata nuk duan t'ia dinë për asgjë, vetëm duan që të gjejnë ca lekë në çdo mënyrë për të blerë pluhurin.

E.B: Më flisni pak për jetën tuaj, familjen tuaj?

Familja ime është e përbërë prej tetë vetash, ndërsa nëna më ka vdekur që kur isha dy vjeç. Kur mbusha nëntë vjeç më çuan në shkollë riedukimi, nga viti 1979 deri në vitin 1983. Pasi dola nga shkolla e riedukimit, fillova të përdor alkoolin shumë dhe e bëja në fshehtësi.

Erdha në Tiranë në vitin 1994, ku për shumë vite kam jetuar me qira, pasi nuk kisha lekë për të blerë shtëpi. Kur nuk kisha lekë për të paguar qiranë, dilja dhe flija dhe në rrugë. Këtu pasi drogohesha shpesh, kryeja edhe vjedhje, ku në të shumtën e rasteve kam shkuar dhe në burg.

Kur isha në burgun 313 në vitin 2004, unë njoha një vajzë, e cila ishte gjithashtu e dënuar për një vepër penale. Kur ajo doli më dërgonte dhe i dërgoja letra nga burgu dhe pasi dola u martova me të. Por ajo nuk e dinte se unë isha përdorues droge.

Në vitin 2005, dola nga burgu dhe e takoj dhe e dërgova në shtëpinë time në Berat, ku qëndruam shumë pak, pasi atje nuk kishte mundësi punësimi. Në 2006-ën unë u arrestova përsëri, duke qëndruar një vit dhe bashkëshortja ime gjatë kësaj kohe mbeti e vetme dhe jetonte me qira.

E.B: Aktualisht nuk vazhdoni më të jetoni me bashkëshorten tuaj?

Në vitin 2008 më lind një djalë dhe për gjashtë muaj unë rrija në shtëpi, ndërsa nusja punonte. Në shtëpinë ku jetonim vinin vazhdimisht të droguar dhe ky është momenti që bashkëshortja ime e kuptoi që unë isha një përdorues droge. Ajo nuk e dinte se unë nuk shkoja në shtëpi asnjëherë në gjendje euforike.

Një ditë më kapi me një shiringë, e cila ishte me gjak, dhe që nga ky moment filluan grindjet. Vjen një çast dhe më shikon në shtëpi duke u droguar. Më pas merr djalin dhe largohet në një qendër rehabilitimi. Po bëj katër muaj që jemi divorcuar dhe nuk e kam takuar bashkë me djalin.

E.B: Do bësh përpjekje për t'u bashkuar?

Do mundohem ta lë përfundimisht drogën dhe të bashkohem me familjen time. Unë momentalisht jetoj jashtë pasi nuk kam shtëpi. Droga ishte ajo që më shkatërroi përfundimisht me familjen, pasi u divorcova me gruan në momentet që ajo e merr vesh se unë isha përdorues droge.

Kur u martova para dy vjetësh, i dhashë një kuraje vetes se nuk do të pija më drogë, por kur të lindin konflikte në familje pastaj detyrohesh ta nisësh përsëri. Përpjekje po bëj, pasi e kam reduktuar sasinë që konsumoj në një javë apo muaj.

E.B: Keni ndonjë mesazh për përdoruesit drogës

Po. Desha t'ju them të gjithëve atyre që janë përdorues droga, se përdorimi i saj është shkatërrues dhe të rrinë sa më larg saj dhe sa më afër familjes së tyre.

7 ***

Në intervistën për “Shekullin”, 27-vjeçarja rrëfen jetën e saj si përdoruese droge prej 10 vitesh. Vajza ime 5-vjeçare i di të gjitha

“Droga s’më la të jem nënë e mirë, vajza më kritikon”

Nuk gjen forcë për të mposhtur pendimin për atë që ka bërë kur ishte shumë e re. Tashmë ndihet akoma më fëmijë se vajza e saj 5-vjeçare, për të cilën thekson se është i vetmi motiv që ende jeton. B. D., është 27 vjeçe dhe prej 10-vitesh është përdoruese heroine. Ajo tregon për gazetën “Shekulli” historinë se si përfundoi në botën e drogës, momentet e vështira kur u bë nënë, edhe pse ishte

përdoruese droge, përballja me familjarët e saj dhe problemet që ka pasur me policinë, duke mos i kursyer goditjet edhe kur ishte shtatzënë.

E.B: Sa vjeçe jeni?

Jam 27 vjeçe.

E.B: Mbani mend si e keni filluar drogën për herë të parë?

Po mbaj mend diçka. Në fakt e mbaj mend këtë situatë pothuajse të gjithën, pasi nuk do më hiqet kurrë nga mendja.

E.B: Si ndodhi?

Jetoja afër “Shkollës së Bashkuar”. Isha vetëm 17 vjeçe dhe u lidha me një djalë që ishte 2 vjet më i madh se unë. Unë e kisha pikë të dobët atë djalë, dhe kur e kuptova që ishte përdorues ishte shumë vonë...

E.B: Më thoni ju si e filluat, a ndikoi i dashuri juaj që të filloni drogën?

Jo, ai nuk ka dashur kurrë që unë të bëhesha përdoruese. Unë u shtyva nga kurioziteti dhe ia dhashë lekët shokut të tij që të ma siguronte. Kjo gjë ndodhi me foli (varak) që herën e parë.

E.B: Po më pas, çfarë ndodhi?

Fillova të bëhesha më keq, pasi u bëra vartëse?

E.B: Ku i gjenit lekët për të siguruar heroinën?

Në fillim mi jepnin ata atë të shtëpisë, pasi nuk e dinin se isha përdoruese dhe më besonin. Iu thosha se më duhet të shkoj në ndonjë ditëlindje apo në aktivitet me shokët dhe më jepnin lekë. Kështu bëja disi, pasi heroina, kur e kam filluar unë, nuk ka qenë kaq shtrenjtë. Më pas prindërit e kuptuan se isha përdoruese dhe reaguan shumë keq. Lekë, as nuk bëhej fjalë të më jepnin. U lënduan shumë kur e zbuluan këtë fatkeqësi.

E.B: Po kur mbetet shtatzënë, sa vjeç ishe dhe a vazhdoje të përdorje drogë?

Isha 22 vjeçe dhe sigurisht që vazhdoja të isha përdoruese.

E.B: Po babi i fëmijës ishte përdorues?

Jo, ai nuk ishte. U mundua shumë të më hiqte nga ajo rrugë, por për fatin tim të keq nuk ia doli. Kjo më kushtoi shumë, pasi u ndava nga bashkëshorti dhe vajzën e mora në shtëpinë time. U mundua të më rikthente në shtëpi, por unë e dija se do të vuante edhe ai për këtë shkak, ndaj vendosa të mos kthehem.

E.B: Fakti që je përdoruese droge prej 10-vitesh, ka pasur probleme me drejtësinë?

Shumë probleme. Duke ditur se jam përdoruese droge më kanë kapur disa herë pa asnjë arsye. Madje, edhe më kanë ofenduar dhe më kanë keqtrajtuar. Momentin më të vështirë e kam pasur kur isha shtatzënë 4-muajsh dhe më mbajtën në rajon rreth 12 orë pa asnjë arsye.

E.B: Thatë se keni një vajzë 5-vjeçare, e keni vështirë për ta rritur dhe edukuar atë?

Në fakt, e kanë rritur më shumë prindërit e mi. Ju nuk e besoni, por ajo mund të jetë më e rritur se unë, pasi është shumë e zgjuar. I dëgjon të gjitha debatet në shtëpi dhe përveç qortimeve që më bëjnë prindërit, mundohet edhe ajo të më kritikojë për vesin që kam. I di të gjitha për drogën, metadonin, trajtimin. Më pyet shpesh se ku do të shkoj dhe nëse jam e rregullt në trajtimin me metadon. Më vjen keq që nuk mund të jem një nënë më e mirë për të, por gjithsesi ende do mundohem.

E.B: Si do mundoheni?

Të lë drogën, tani që jam në metadon. Do ta bëj së pari për vajzën time. Shpresoj që do t'ia dal, sepse e kam motiv të fortë fëmijën tim për ta lënë.

E.B: Jeni pënduar që keni përfunduar kështu?

Jam pënduar shumë dhe nuk gjej dot forcë për të mposhtur këtë pendim. Droga më ka shkatërruar dhe i vetmi motiv që jetoj tashmë është fëmija im. Nëse nuk do të isha bërë përdoruese droge, tashmë do të kisha mbaruar shkollën e lartë, sepse kam qenë nxënëse shumë e mirë dhe do të kisha një punë të mirë, ku të mundesha të rrisja vajzën time si gjithë të tjerët me nder dhe përkushtim.

Psikologjia e Qendrës Aksion Plus, Enkelejda Ngjelina, shpjegon se prindërit duhet të tregojnë kujdes me adoleshentët

Psikologjia:

“Vajza 5-vjeçare, motivi kryesor që pacientja të lërë drogën”.

Prindërit duhet t'u rrinë sa më afër fëmijëve adoleshentë, në të kundërt mund të përfundojnë në rrugë të gabuara që mund t'u kushtojë gjithë jetën. Kështu shprehet psikologjia pranë Qendrës Aksion Plus, Enkelejda Ngjelina, e cila punon me përdoruesit e drogës prej 7-vitesh. Ndërkohë, ajo shpjegon edhe rastin e 27-vjeçares B.D., sipas të cilës historia e saj ka nisur që në moshën 17-vjeçare. Ka qenë e lidhur me një djalë përdorues heroine. Sipas psikologes, është nga të vetmet raste, ku pacientja nuk ka filluar me hashash, por ka kaluar direkt në heroinë. “Ky rast vjen nga një familje normale dhe me një ekonomi familjare normale; prindërit e saj kanë dhe një biznes. Por pasojat e sjelljes antisociale që pëson vajza vijnë ndoshta dhe nga mungesa e kontrollit prindëror, apo i një interesimi të ulët të tyre kundër vajzës, duke qenë se moshën e adoleshencës është një moshë shumë e vështirë dhe mosinteresi i të afërmeve e dërgon atë drejt heroinës”, pohon psikologjia Ngjelina.

Ajo shton se edhe lidhja sentimentale e kësaj përdorueseje me një përdorues intravenoz ka bërë që ajo të shkojë drejt kësaj rruge. Ndërkohë, psikologjia thekson se duke mos pasur informacionin e

mjaftueshëm, si në shkollë si në familje, apo nga grupi shoqëror, të gjitha këto bënë që në fillim vajza të nisë heroinën dhe më pas të lindë edhe një fëmijë, ndërsa ajo ishte përdoruese droge dhe e papërgjegjshme për veprimet e saj. “Sigurisht që është me e vështirë të punosh me prindër përdorues droge” - shprehet Ngjelina.

Kjo edhe për arsye se një person që merr drogë apo është në terapinë e metadonit duhet të ketë një motiv shumë të fortë për ta lënë drogën, pasi duhet të jetë i përqendruar. Rasti në fjalë ka një motiv më të fortë për të hyrë në terapi, pasi fëmija i saj është motivi kryesor për ta lënë drogën. Duhet të dini se personi kur merr terapinë nuk duhet të marrë droga të tjera. Rasti në fjalë është hera e dytë që futet në metadon” - pohon psikologja, duke shtuar se vajzën kanë filluar ta aktivizojnë edhe me punë, për ta bërë që të ndihet më e vlerësuar dhe e motivuar për të hequr dorë nga përdorimi i drogës.

8 ****

Dikur përdoruese, tashmë në ndihmë të tyre

Ajo i njeh dhe i kupton më mirë se kushdo tjetër. Dikur ishte një nga ata, ndërsa sot është në shërbim të tyre. Madje vullneti i saj është aq i madh sa punon dhe trajtohet njëkohësisht me metadon. O. H është 25 vjeçarja e cila ka përdorur heroinë prej 7 vitesh ndërsa tani jo vetëm që ka gjetur forcë për ta lënë por po ndihmon edhe shokët e saj.

”Dil nga rrethi”. Kështu quhet projekti në cilën 25-vjeçarja po punon me mbështetje të Qendrës “Aksion Plus”. Ajo shpjegon se vetë titulli ka një përkufizim domethënës. “Na le të kuptojmë se futja në këtë rrugën s’është aspak e mirë dhe që të dalësh duhet të kërkon ndihmë dhe të japim ndihmë. Nuk është ideja të paragjykojmë absolutisht për zgjedhjen e secilit, por të mundohemi të ndalojmë që çdo kush të kuptojë se injektimi nuk është zgjidhja e duhur”, thekson 25 vjeçarja duke shtuar se ”Dil nga rrethi” ka marrë inisiativën të përcjellë njohuri të munguar te përdoruesit e drogës sidomos te injektuesit me shiringë. Kjo fushatë sipas saj ka synim zvogëlimin e dëmit duke ndërhyrë drejtpërdrejt me injektuesit e vjetër sepse hapi i parë fillon këtu duke ndërgjegjësuar përdoruesit e vjetër se pasojat që sjellin bisedat, injektimi në sy të jo-injektuesve i dërgon të tjerët që të ndjekin shembullin e tyre. “Disa nga pyetjet bazë që bëjnë punonjësit në terren për të mësuar më shumë rreth injektuesve, veprimtarinë e tyre, fillimet e injektimit dhe më e rëndësishmja sa janë të informuar me pasojat e injektimit dhe sa janë të gatshëm që injektojnë të tjerët për herë të parë apo jo”, - pohon vajza. Ndërkohë ajo shpjegon se nga përgjigjet e disa përdoruesve që i ka të njohur prej vitesh nuk duan që të injektojnë të tjerët për herë të parë, por nëse ata janë të gatshëm të ofrojnë ndihmë si rrjedhojë ekonomike d.m.th të ndajnë drogën bashkë ose ju vjen keq për shoku-shoqen në këto raste edhe të rinjtë përfshihen.

Në fakt 25 vjeçarja tashmë është bërë ndihmë për stafin e “Aksion Plus” pasi ajo është njeriu që komunikon dhe depërton më shumë tek problemet e përdoruesve të drogës. “Kuptohet se përdoruesit e drogës janë vërtet të afërt me njëri-tjetrin pasi konsiderohen të një kategorie. Ata kanë kodet, mënyrën e të folurit dhe zakonet e tyre. Unë tashmë i njoh të gjitha këto dhe nuk e kam aspak të vështirë të punoj me përdoruesit madje e jam e afërt dhe me ta dhe mundem të nuhas çdo problem që kanë”, - thekson 25 vjeçarja ish përdoruese droge.

Isha buzë varrit, por mjekët më kthyen kurrizin

Dhimbja dhe lëndimi e kanë ngërthyer fort sa në momente të caktuara nuk e ka dashur jetën. Bluzat e bardha të cilat janë të veshur me petkun e humanizmit duket se e kanë harruar këtë mision duke I mohuar pacientit ndihmën shëndetësore. Kështu ka ndodhur me 22 vjeçaren. A.L përdoruese droge për 5 vitesh. Nuk e kishte menduar kurrë që në pikën më kritike mjekët t'i kthenin krahët madje edhe ta përbuznin. Të drejtën për të marrë ndihmë shëndetësore e kishte edhe ajo, edhe pse është përdoruese droge. Zëri i dridhet tek tregon historinë lënduese, por duket qartë se kjo histori ka lënë gjurmë në jetën e saj.

E.B: Mund të më thuash rutinën e një vajze që është përdoruese droge?

Në fakt ju këtë nuk kuptoni. Ne mund të konsiderohemi njerëz pa rutinë, pa kuptim të pa shpresë të pafë dhe ku ta di unë çfarë. Po në fakt ja që jemi edhe ne. Nesër mund të jetë edhe dikush tjetër madje edhe njerëzit e atyre që na kthejnë kurrizin dhe na lëndojnë sikur të mos ishim qenie njerëzore. Merreni si të doni, por edhe ne përpiqemi të mbijetojmë ashtu si mundemi. Gabuam, ndoshta pa dashje, dhe po paguajmë shtrenjtë për ato gabime edhe pse nuk kemi lënduar askënd.

E.B: Dukeni e lënduar dhe disi e zhgënjyer përse ka ndodhur kjo?

Në fakt jam më shumë se e zhgënjyer dhe është pak të them se jam e lënduar. Ndihem e shkatërruar deri në qelizën e fundit dhe kjo jo vetëm për shkak të helmit të bardhë që marr por edhe për shkak të kësaj shoqëria që nuk na pranon është siç jemi. E di që edhe ne kemi fajet tona por nuk duhet të braktisemi aq më tepër nga njerëz që vishen me petkun e bardhë në emër të humanizmit dhe nuk e dinë se çfarë është humanizmi i vërtetë.

E.B: Mund të më thoni se çfarë të ka ndodhur konkretisht?

Ne na ndodhin shumë gjëra por në fakt ajo që vërtet më ka lënë gjurmë ishte një ndodhi në një spital publik këtu në Tiranë. Isha sëmurë rëndë. Helmimi më kishte shkuar deri në palcë dhe nuk po mbaja dot as veten në këmbë. Ashtu e dërrmuar shkova e shoqëruar me motrën time në spital, aty ku ndihmohen të sëmurët. Në fakt me mua nuk ndodhi kështu, por të gjithë mjekët më kthyen kurrizin - sapo panë krahët e mi të nxira nga shiringat që kisha bërë. Askush nuk më afrohej edhe pse motra ime ju përgjërohej të më jepnin ndihmë. Në ato çaste e harrova veten time edhe pse isha buzë varrit, dhe u mundova të gjej pak forca të paktën për motrën time. Nuk doja ta shikoja më tek qante dhe lutej që dikush të më ndihmonte. Ishte e tmerrshme.

E.B: U ankuat në ndonjë institucion për këtë ngjarje?

Nuk e mora fare mundimin sepse përdoruesit e drogës për askënd nuk kanë të drejta. Madje edhe këtë histori ua rrëfeva për të mos e mbajtur brenda meja. Është lehtësi edhe të flasësh. Ndoshta një ditë do të respektohen të drejtat e çdo njeriu.

Perdorues me shiringe dhe me hunde.

Kam qene ne Greqi dhe isha 13 vjeçe. Shoqja e shkolles sime ne Greqi pinte mall, por une s'e dija. Si femije i levizur qe kam qene shisja droge, dhe nuk e dija çfare shisja. Leket ja jepja mamit dhe ndonjëherë i fshihja se kur me kapte policia ia tregoja mamit qe t'i gjente.

Nje dite i shikoj kësaj shoqes mallin në dorë i them se pse e pi, dhe doja ta pija dhe vete. Jo me tha, mos e provo kurrë, dhe ajo shkon ne banje sepse ne ishim ne shkolle.

Rastesisht i shkoj nga pas, aty e shoh që ajo bënte mallin me shiringe. Fillova dhe unë me hunde sepse e kam pasur neper duar. Doja te dilja prap te kjo shoqja; kjo ishte vetë te vendi ku behej malli ne Greqi, siç kemi dhe ne vendet tona ne Shqipëri. Une isha nisur per vete, kur me del dhe me ngel ne duar, kjo kishte vdekur. Mire qe ishte roja i asaj godine qe i tregoi policisë. Qe atehere une nuk e kam lënë mallin. Pavarësisht se e kam lënë me raste, por në përgjithësi jam pesimiste. Une s'jam te Metadoni por dua te futem, të pakten të integrohem në shoqëri. Mos të vjedh, dhe te mos merem me pislleqe sepse sa kam dalë nga burgu.

Perdorues X

Isha ne nje pyll, në makinë me disa shokë qe injektonin, te cilet e kishin bere injeksionin dhe herë tjetër, po jo në syte e mi. Mua me shtyu kureshtja. Ai me ndihmoi qe te injektoja jo per arsye ekonomike, por sepse tha se ishte gjendja më e bukur. Unë nuk dija ta bëja vetë dhe me ndihmoi shoku im për te gjetur damarin.

Kisha dëgjuar vetëm nga shoket sepse aty ku kam jetuar une ne Burrel nuk kishim neper shkolla informacion për përdorimin e drogave. Ne fillim m'u duk e frikshme shiringa, por ma perforcioi gjendja e bukur, dhe se ne këtë mënyre kushtonte me pak. Me folio, se me hunde kisha parë, por me shiringe jo, dhe di qe me foli ose hunde eshte dëmi me i vogël.

Me ndodh shpesh, here sepse kur nuk kam dammar, dhe s'e gjej dot me duhet te me ndihmojne shokët.

Kam ndihmuar nje shok dhe jo gjithonë, ose kur nuk i njoh kam frikë se mos më kalojë ne mbidozë.

Perdorues jo me injeksion, vetem historia.

Dikur ne 1995 kisha shume leke neper duar. Kisha nje shoqe. Kisha lidhje me nje shok grek i cili sillte mall. Une pija me cigare, filloi te pije dhe shoqja ime, dhe me pas u be nje rreth qe pinim mall, sepse ne ate kohe ne Shqipëri pak veta e njihnin mallin. Në nje fare mënyre çdo gje ishte e fshehur dhe kur pinim ne ndonje shtepi shoku ose hyrje pallati, sepse ishte diçka qe ne e ndienim dhe vete qe eshte diskriminuese ne shoqëri shqiptare. Kur jam kapur nga policia kam pasur diskriminim, por si gjithonë policia kërkon kokat, dhe ne qe pijmë jemi asgje në syte e tyre. Edhe tani qe pi Metadon, jo se e ndjej veten se jam kuruar e jam sheruar, po te pakten po integrohem ne shoqëri te re. Kam ne mendje te gjej pune, dhe prap me familjen jam ne dilemë, sepse ata jane lodhur nga gjithë kjo periudhe qe kane vuajtur me mua; jo burgu, jo malli, veçse kam pasur nje te mire se nuk kam perdorur shiringë. I bej thirrje te gjithë mallistave se shiringa nuk eshte shpetimi, siç nuk eshte malli vetë, por te pakten te marrin Metadonin e te mos abuzojne me drogen. Gjithsesi po ta ktheja kohen mbrapa nuk do ta provoja kurrë.

1- Vetëm histori

Kisha rënë ne nje rreth shokesh qe pinin mall me foli. Une isha 19 vjeçe, nuk di si t'i shpjegoj rrethanat, si e fillova dhe vetëm me hunde. Ndarja e prindërve, jo se ishte gje e vogël, po për mua ishte justifikim. Ne vitet 2000 kur fillova te pija mirë perditë, kisha dhe probleme me policine. Ne çdo kapje kemi qenë te diskriminuar nga policia sepse edhe kur nuk i kisha bere vjedhjet isha kontigjent policie, dhe per çdo vjedhje jemi ne mallistat që shkojme te parët ne polici, edhe po ta ktheja koken mbrapa nuk besoj se do beja kete jetë që kam bërë gjithë këto vite. Kam qenë i mbyllur ne shtëpi, po ky eshte nje realitet qe ka ndodhur jo vetem te une, por të të gjitha moshat e reja qe perdorin heroinë. Jemi kategoria më e persekutuar e shoqërisë. Na duhet forca jonë vetjake e kontrollit që ta thyejme këtë mal endrrash ku na fuste droga. Do një forcë shpirtërore dhe shoqerore qe te dalim nga kjo situatë. Kjo eshte nje pjese e vogël e historisë time sepse po te tregojmë vuajtjet tona, kush do i lexoje, do thote e ka pasur nga qejfi. Qejfi eshte ne fillim, tani unë po vuaj pasojat. Mesazhi qe ju jap te rinjve eshte qe te mos ta provojne kurrë.

HISTORITE E SHERBIMIT TE PROVES

Shërbimi i Provës

Shërbimi i Provës është organi shtetëror, që mbikqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimeve alternative, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Kjo e fundit është pjesa më humane nga e cila sipas sistemit të drejtësisë penale vihet në favor të të dënuarit, ndërsa pjesa e parë e këtij përcaktimi na tregon punën konkrete që ky institucion kryen duke bashkëpunuar me organet e tjera.

Shërbimi i provës kryen aktivitetin e tij në bazë të vlerave që përmban ky sistem, sepse ky shërbim mund të konsiderohet një organizatë me vlera, vlera të cilat janë konsideruar si vlera me cilësi ndërkombëtare duke u identifikuar në:

1. Respekt për individët, vlerat e njerëzimit, integritetin njerëzor si dhe jetën private të individëve,
2. Respekt për dinjitetin njerëzor,
3. Drejtësi, sinjeritet dhe përgjegjësi,
4. Parimi i ndërhyrjes minimale, të mos përdoret më shumë forcë nga ajo e nevojshme,
5. Parimi i normalizimit, i cili konsiston në faktin se kushtet për të dënuarit jashtë sistemit të drejtësisë penale,
6. Parimi i ndërhyrjes në kohë për të siguruar një reagim të vlefshëm ndaj veprës penale dhe për të trajtuar një çështje me efikasitet, punonjësi i shërbimit të provës duhet të ketë hyrje tek të dënuarit në fazën e procesit të drejtësisë penale,
7. Parimi i ndërhyrjes së vazhdueshme të çdo faze duhet të ndiqet nga punonjësit e shërbimit të provës duke ofruar efektivitet,
8. Gatishmëria e bashkëpunimit me organizata të ndryshme në ndihmën e dhënë për rehabilitimin e

autorëve në mënyrë sa më të frytshme.

Mbi këto vlera thelbësore, bazohet shërbimi i provës në punën që kryen, megjithatë duhet thënë se edhe pse nga rëndësia që mbartin këto vlera kjo nuk është e mjaftueshme për të treguar se çfarë është në të vërtetë ky shërbim, e rëndësishme është që këto t'i bashkangjiten edhe ajo se çfarë bën ky shërbim dhe si arrin ta realizojë këtë.

Legjislacioni bazë i Shërbimit të Provës në Shqipëri

Legjislacioni bazë në Shqipëri bazohet në ligjin nr. 10023 që mban datën 27.11.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7895 ,date 27.01.19952 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.10024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime shtesë në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Alternativat e dënimit duhet të theksohet se jepen në rast se gjykata ka dhënë paravendimin për to dhe se për herë të parë janë përdorur nocione të tilla si: Gjysmëliria, neni 29, Ekzekutimi i vendimit në gjysmëliri

“Neni 30:

Shërbimi i provës mbikëqyr personin e dënuar me gjysmëliri, kur ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale”.

Kjo wshtw njw pjesw e punws sw rëndësishme që kryen shërbimi i provës dhe pjesw e kwtyw vwzhgimi janw dhe raportet përfundimtare në lidhje me të dënuarit, raporte që paraqiten nw gjykatw dhe që do të vendosin si do të vazhdojë masa e dënimi tw marrw.

Dhe pasohet me pas me ndryshime te tjera ne nenet perkatese:

Ekzekutimi i vendimit “Punë me interes publik”

Kontaktet me shërbimin e provës gjatë kryerjes së punës me interes publik

Moskryerja e punës

Pezullimi i vendimit për punë me interes publik

Ekzekutimi i vendimit me qëndrim në shtëpi

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë

Ekzekutimi i vendimit të lirimit me kusht.

1- Alternativa që më dha shpresë për jetën

Fajtor apo jo...! Kjo ka më pak rëndësi për të. Ajo çka vërtet i vlen në këtë periudhë është fakti që i është dhënë një alternativë dhe këtë ia kanë ofruar me anë të shërbimit të provës. Nuk është në burg as në paraburgim, pikërisht aty ku gjen vuajtjen dhe përbuzjen. G.M është rreth të 30-tave dhe vërtet ndihet i përgjegjshëm, pavarësisht çfarë i ka ndodhur ai është aty duke u rropatur në maksimum që të përfitojë nga kjo alternativë e mirë që i është dhënë. Ai tregon për historinë e tij dhe thekson se

ndihet me fat që është larg izolimit, por është pjesë e Shërbimit të Provës dhe me ndihmën që shoqata Aksion Plus po i ofron, jo vetëm për të lënë përdorimin e drogës, por edhe duke i ofruar ndihmë tek Shërbimi i Provës.

E.B: Ju jeni një ndër përdoruesit e drogës të cilat keni pasur edhe konflikt me ligjin. Mund të më shpjegoni përse jeni akuzuar?

Është histori e gjatë e cila më ka kushtuar por mund të më kishte kushtuar edhe më shumë. Së pari dua të shpjegoj se kam vite që jam përdorues droge, e si i tillë gjithkush mund të mendojë se jam burim problemesh. Unë kam jetuar në Greqi për disa vite, dhe kur u ktheva këtu bleva diku rreth 6 gram kokainë. E doja për ta konsumuar. Fundja thashë, unë përdorues isha. Forcat e rendit më kapën me këtë sasi droge dhe më arrestuan. Nuk dua të kujtoj çastet e paraburgimit se nuk kam fjalë t'i përshkruaj. Më pas erdhi dita e gjyqimit, ku edhe këtu u ndjeva i shkatërruar tërësisht dhe pa asnjë shpresë.

E.B: Çfarë ndodhi konkretisht?

U akuzova nga prokurori si shitës droge dhe kërkoi dënimin tim me 6 vjet burg. Ishte e tmerrshme kur e dëgjova. Unë kurrë nuk kam shitur drogë, por me këtë sasi më thanë se ligji nuk ishte në anën time. I ndodhur në këto kushte kërkova që të gjendet të paktën një dëshmitar të cilit unë i kisha shitur drogë. Nuk kisha ndonjë mënyrë tjetër për t'i bindur. Unë vërtet nuk jam, dhe as nuk kam qenë ndonjë herë tregtar droge. Fatkeqësisht përdorues po, por asnjëherë nuk kam bërë tregti me drogë. Pas kërkesës së prokurorit për dënimin tim mendova se çdo gjë mori fund, por për fat të mirë jo çdo gjë ishte kundra meje. M'u ofrua edhe një alternativë që është pikërisht Shërbimi i Provës.

E.B: Më trego në lidhje me këtë shërbim çfarë përfiton dhe çfarë të ofrohet?

Përfitoj shumë. Mbi të gjitha nuk jam i izoluar, pa asnjë shpresë. Vërtet është liri me kusht, por për mua është një rreze drite ku mund të më jepen shumë mundësi. Riintegrohem në punë dhe shoqëri, dhe kjo është shumë e rëndësishme. Pra është një dritare për ne. Paraqitem çdo javë në shërbimin e provës, dhe flas me psikologët dhe punonjësit e tjerë. Tashmë kam mundësinë të punoj dhe pse jo të ndihmoj disi veten time dhe familjen të cilët i kam munduar shumë.

2- Alternativa që në bën të jetoj me dinjitetet

Është alternativë, dhe alternativat gjithnjë janë favorizuese, pse jo edhe të mira. Ndihet me fat se edhe për ata ka alternativa, ndonëse tek-tuk bëjnë ndonjë rrëmujë, siç i quan ai dhe bëhen "hasëm" me ligjin. M.D është një përdorues tjetër droge i cili po kryen Shërbimin e Provës. Prej vitesh ai është klient i rregullt tek shoqata Aksion Plus, dhe bashkë me stafin e kësaj shoqata po përpiqet në maksimum të heqë dorë nga vesi që po i shkatërron jetën.

E.B: Jeni përdorues droge dhe në konflikt me ligjin. Cila nga këto dy probleme është më i rëndi?

Më duket pyetje diplomatike, por unë dua të theksoi se janë të dy vepra të rënda dhe aspak komode për të bërë një jetë normale si të gjithë ata djemtë dhe vajzat e mira të cilët nuk kanë vese. Duhet të

dini se askujt nuk ja uroj të ketë probleme të tilla, sepse në këto kushte je sidomos i keqi i vetes. Ajo çka është e rëndësishme është fakti se duhet të gjesh forca për të dalë nga zinxhirët që të ngërthejnë deri në grykë, për shkak se nuk kemi ditur të menaxhojmë si duhet jetën tonë. E nëse dikush të jep dorën në këto kushte, është më shumë se mik.

E.B: Në fakt kush mendoni se kanë qenë ndihmë për ju, apo siç thuhet, ju ka dhënë dorën?

Është së pari stafi i Aksion Plus-it që nuk na kanë braktisur, por na ndihmojnë me gjithçka që ne të arrijmë të dalim nga zinxhirët që ju thashë pak më parë. E thënë me thjesht, na ndihmojnë për të lënë vesin e poshtër të drogës. Pastaj është edhe Shërbimi i Provës i cili për mua ka qenë një alternativë shumë e mirë, dhe na ka mbështetur shumë. Nuk e di çfarë do të kishte ndodhur me mua nëse do të kisha kryer dënimin në burg. Ky i fundit është më i keq se zinxhirët, në fakt është një frigorifer i akullt ku duhet të rrimë të ngrirë si të ishim të vdekur. Pra burgu është një vend pa alternativë, ndaj dhe e vlerësoj shumë alternativën e Shërbimit të Provës, dhe jam gjithnjë korrekt në shlyerjen e detyrimeve që kam.

E.B: Cila është arsyeja që keni jeni në konflikt me ligjin?

Në fakt kur je përdorues droge ndodh të jesh i paragjykuar nga të gjithë. Nuk dua të shfajësoj veten sepse edhe ne kemi faje, dhe për to duhet të paguajmë. Pra ndodh të bëjmë ndonjë zullum apo rrëmujë, por kjo nuk do të thotë që të vihemi para gjyqinës, se njerëz jemi edhe ne. Dhe që të kthehem tek faji që kam bërë, sigurisht që nuk ishte i vogël. Unë isha pjesë e një konflikti shërresh që u bë mes disa djemve. Ishte një konflikt që pati disa pasoja, ndaj dhe mora dënimin. Megjithatë dua të theksoj se jam në këtë dënim, po e kryej me dinjitet, dhe besoj se do t'ia dal Shërbimi i Provës po më jep mundësinë të trajtohem me metadon, të punoj dhe të jetoj me dinjitetet si gjithë të tjerët.

3- Shërbimi i Provës më bën të ndihem i respektuar

Rrezaton mirësi dhe të jep përshtypjen e djalit të mirë. Të paktën kështu duket kur e takon për herë të parë tek nis bisedën me të. Megjithatë ai nuk nguron të tregojë edhe veset që ka, por sipas tij e rëndësishme është që mundohet t'i rikuperojë ato. N.D është 33 vjeçar, dhe prej 12 vitesh ka konsumuar lëndë narkotike. Por ky nuk është problemi i vetëm i tij sepse ka pasur edhe konflikt me ligjin. Kjo është edhe arsyeja që ai është në Shërbimin e Provës të cilin e konsideron si një alternativë shumë të mirë, ndonëse thekson se ka qenë thjesht viktimë e një mosmarrëveshje që nuk u zgjidh kurrë. Shërbimi i Provës sipas tij e bën të ndihet i respektuar dhe i dobishëm, sepse nuk e ka lënë punën asnjëherë.

E.B: Ju jeni një nga përdoruesit e Shërbimit të Provës; mund të na thoni arsyet se përse ndodhëni në këtë shërbim?

Jam akuzuar për një celular të vjedhur. Në fakt unë e bleva atë celular dhe fola me të gjithë njerëzit e mi. Policia zbardhi bisedat dhe m'u ngarkua mua celulari i vjedhur, ndonëse unë e kisha blerë në rrugë. Prokurori kërkoi dënimin me dy vjet. Nuk munda të vërtetoj të kundërtën, që celularin e kisha blerë, ndaj dhe duhej të mbaroja dënimin. Për fat mirë u hap një dritë jeshile për mua që të mos mbeteshia i izoluar brenda mureve të burgut, aty ku askush nuk dëshiron të shkojë. Kjo dritë jeshile

është Shërbimi i Provës i cili na jep mundësinë të ndihemi qytetarë, dhe të respektuar. Personeli është shumë i përgatitur dhe për ne janë mbështetje. Jam gjithnjë korrekt me oraret kur duhet të paraqitem pasi nuk dua të abuzoj me këtë alternativë të mirë që na është dhënë.

E.B: Ju pretendoni se jeni i pafajshëm, përse mendoni se ndiheni me fat që jeni në Shërbimin e Provës ndaj të cilit keni edhe detyrime?

Keni të drejtë për këtë që thoni, por duhet të dini se ne jemi përdorues droge dhe si të tillë jemi shumë pak të besueshëm. Akuza, që nuk munda ta vërtetoj të kundërtën, dhe në këto kushte mund të kisha përfunduar edhe në burg. Burgu është i tmerrshëm dhe nuk ja uroj askujt. Ndaj them se tashmë kam një alternativë të mirë.

E.B: Me çfarë merreni gjatë kohës që nuk jeni i impenjuar me Shërbimin e Provës?

Punoj. Unë punoj gjithë kohës. Kemi një biznes të vogël familjar me tapiceri dhe unë punoja aty. Nëse nuk do të ekzistonte Shërbimi i Provës mendoni vetë se si do të ishte fati i një të riu brenda në qeli pa asnjë alternativë. Ky është një shans i mirë ndaj dhe e respektoj sepse është në dobinë time.

Historitë e familjarëve

1- “Më braktisën të gjithë, se djali im ishte përdorues”.

“Jam detyruar t’i jap tim biri vetë drogë sepse nuk duroja dot dhimbjet dhe ulërimat e tij. Ai nuk mundi më të rrinte pa helmin e bardhë që po i shkatërron jetën atij dhe familjes”. Janë këto fjalët e një nëne përdoruesi droge, e cila rrëfen dhimbjet dhe vuajtjet që po i shkakton helmi i bardhë. Ka dhënë gjithë jetën mësim dhe dije për adoleshentët në gjimnaz, por kurrë nuk e kuptoi se ku gaboi me të birin i cili ju fut rrugës së drogës.

Tashmë është ajo që e ndjek në çdo çast duke i dhënë forcë dhe shpresë se mund t’ia hedhë këtij ferri ku është futur. M.D është nëna e 22 vjeçarit D.D i cili prej 5 vitesh trajtohet me metadon në Qendrën “Aksion Plus” e cila tregon historinë e saj të trishtë duke përcjellë dhimbjen e një nëne se biri i saj është përdorues droge.

Dhimbje dhe lëndime që vetëm një nënë mund t’i vuajë. Vesi që djali i saj kishte marrë si përdorues droge, jo vetëm do t’i shkaktonte dramën e jetës, por do të ndiente për herë të parë edhe diskriminimin që do t’i bënin të gjithë personat që e njihnin. “Nuk mund të përshkruaj tronditjen që ndjeva kur mësova që im bir ishte përdorues droge, por goditja më e madhe ishte kur të gjithë njerëzit më kthyen kurrizin sikur im bir të ishte pjella më e keqe e shoqërisë. Në fakt ai i bëri keq vetëm vetes dhe familjes së tij, që po vuajmë këtë mizori”, - pohon nëna e të riut e cila nuk mund të fshehtë lotët tek kujton momentet të vështira që lindën nga telashet që do t’i sillte djali i saj adoleshent. E ndonëse këto telashe do t’i kushtonin shumë, zemra e një nëne nuk mundet të braktisë birin e saj, ndaj dhe vendos ta ndihmojë dhe ta mbështesë në çdo moment megjithëse nuk ishte aspak e lehtë. “Nuk mundem të harroi kurrë kur im bir godiste murin me kokë dhe shtrihej përdhe sepse

kërkonte helmin e bardhë. Nuk po e njihja më, por thellë në zemër ndjeja dhimbjen e një nëne. Do t'ia blija edhe vetë në ato çaste drogën, edhe pse e dija se droga po e vriste, vetëm të mos e shihja më në atë gjendje. Uroj që asnjë nënë në botë të mos provojë një dhimbje të tillë; është e tmerrshme dhe e papërballueshme”, - pohon M.D nëna e 22 vjeçarit D.D duke vijuar edhe më tej historinë e saj të trishtë.

Jo vetëm dhimbje, por edhe braktisje, dhe diskriminim. Ajo që kishte mësuar dhe edukuar breza të tërë tashmë ndodhej në mes të rrugëve dhe e mënjanuar edhe nga kolegët dhe shoqëria që e rrethonin. “Kam punuar në arsim për 22 vjet dhe kurrë nuk kam marrë vërejtje për punën time, vetëm lëndata. Më erdhi e papritur, se si m'u shkërmoq para syve i gjithë mudi dhe “faji” im ishte se im bir është përdorues droge. Kolegët, në vend që të më mbështesnin, më kthyen kurrizin ndërsa komshinjtë më shikonin me dyshim sikur jo vetëm djali, por e gjithë familja ime ishin djalli ndaj të cilit duhej t'i rrinin sa më larg”, pohon ajo e lënduar. Megjithatë, ajo thekson se është e vendosur për ta fituar këtë betejë dhe mundohet çdo ditë që djali i saj të heqë dorë nga droga, ndaj dhe ai prej 4 vitesh trajtohet me metadon në Qendrën “Aksion Plus”.

2- “Baba e bir ishim shokë, droga po na lufton”.

“Lutem më ndihmoni çfarë të bëj me tim bir? Ka një sjellje të çuditshme sikur nuk po e njoh më.... Ai padyshim që përdor drogë... po çfarë të bëj unë”? Një baba i merakosur për birin e tij adoleshent kërkon ndihmë dhe këshilla nga psikologët e Qendrës “Aksion Plus” për hallin që i ka zënë derën. Duket shumë i ri në moshë, dhe i veshur me stil dhe me sjellje fisnike. Mesa duket historia e përdorimit të drogës paska trokitur edhe në derën e tij, sepse ai dhe i gjithë familja po vuan këtë dhimbje. H.D 44 vjeçar është babai i adoleshentit B.D tashmë në vitin e tretë të një nga gjimnazeve të njohura të kryeqytetit.

Babai i tij rrëfen stresin që po kalon, pasi testi tregon se djali i tij është përdorues. Ai ka shumë besim tek i biri, por shpjegon se për herë të parë djali i tij ka marrë drogë në mënyrë të pavullnetshme sepse moshatarët e tij ja kanë hedhur në gotë pa dijeni.

“Im bir është aq i urtë, pothuajse nuk ndihet fare, kurrë nuk e ngre zërin. Asnjëherë në botë nuk do të mendoja se im bir do të bëhej përdorues. Madje jam shumë i lënduar sepse ky vendim nuk ka qenë i tij, por është shtyrë nga shokët. Kjo mendoj të ketë ndodhur pak muaj më parë ku im bir ishte i ftuar në një *party*. Kur u kthye në shtëpi në orët e para të mëngjesit m'u duk i verdhë dhe me një sjellje të çuditshme, por nuk ma mori mendja të ketë konsumuar drogë”, - pohon babai i adoleshentit tek flet me mëdyshje, po i zhytur në mendime dhe në halle. Sipas tij sjellja e të birit ka ndryshuar shumë dhe sepse ai nuk hapet më me atin për problemet që ka. Ai pohon se dikur ishin si shokë, dhe çdo gjë e bisedonin bashkë, por tashmë çdo gjë ka ndryshuar. “Lutem më dëgjo se jam babi yt. Më thuaj cili është problemi dhe si mund të ndihmoj”, - i drejtohet të birit tek i duket i pabindur edhe para punonjësve të Qendrës “Aksion Plus”, të cilët mundohen t'i sqarojnë se trajtimi me metadon kërkon vullnet dhe punë, ndryshe nuk mund të funksionojë.

E ndërsa rrjedha e jetës ka filluar të marrë drejtim tjetër dhe aspak të kënaqshëm për birin dhe për babain, ky i fundit lufton me të gjitha forcat që i biri të kthehet sërish në rrugën e drejtë. “Unë e di dhe e ndjej se djali im është sërish i mirë. Unë nuk do ta braktis kurrë atë, por do të luftoj që të jetë

sërish ai i pari, ku unë ta kem bir dhe shok, njësoj si dikur”, pohon babai i adoleshentit i cili nuk i kursen as pyetjet ndaj vetes së tij se ku gaboi, dhe çfarë mund të bëjë me shumë....

3- “Djali im përdorues, policia e torturon”.

Një grua në moshë me flokët e bardha borë, me trup të vogël, por me zemër të madhe për të birin që ndodhet pikërisht aty ku kurrë nuk do e mendonte kurrë se do të përfundonte. Në qendrën ku trajtohen përdoruesit e drogës, aty ku ajo është personazhi i njohur për gjithë stafin e “Aksion Plus” sepse ajo është gjithnjë aty për të ndihmuar të birin, i cili prej më shumë se 10 vitesh konsumon heroinë. A.Gj është 58 vjeç dhe jeton në zonën e Kombinatit. Vitet e tmerrit që po përjeton me djalin përdorues droge duket se e kanë tretur aq shumë sa pak forca i kanë mbetur. D.Gj tregon se gjithë jetën ka punuar në arsim, por për shkak të varfërisë dhe shkatërrimit ekonomik që i bën i biri detyrohet të bëjë dy punë edhe pse është e sëmurë.

Lëndimi më i madh për të është kur vetë forcat e policisë e godasin dhe e torturojnë duke e detyruar të bashkëpunojë me ta, madje të punojë për ta. Ky është pretendimi i një nëne të lënduar, por ajo këmbëngul të tregojë padrejtësitë që bëhen në kurriz të birit dhe pikërisht nga strukturat shtetërore. “Më ka ardhur djali dhjetra herë i dëmtuar dhe i masakruar nga të rrahurat e policisë. Madje në trupin e tij ka shumë shenja të tilla që nuk i janë hequr, madje do t’i mbajë për jetë sepse plagët e goditjeve të policëve kanë qenë shumë të rënda. I kam denoncuar këta policë shumë herë, por ata janë të lidhur me njëri tjetrin dhe asgjë nuk bëhet për tim bir”, pohon D.Gj duke shtuar se jeta e saj është kthyer në një makth të vërtetë tek shikon se i biri po tretet çdo ditë e më shumë jo vetëm nga helmi i bardhë, por edhe nga torturat e policisë.

Më tej ajo rrëfen sfidat e jetës për të siguruar mbijetesën e saj dhe të familjes së varfër. “Punoj paradite si mësuese sepse jap mësim në klasat fillore. Pas mësimit marr një arkë dhe shes banane ku të mundem. Nuk kam rrugë tjetër se im shoq është invalid, ndërsa djali tjetër i papunë. Ndërsa djalin e madh ju e shikoni vetë. i cili jo vetëm që nuk është për punë, por është shkaku kryesor i shkatërrimit të jetës së tij dhe i familjes”, - pohon D.Gj duke shtuar se jeta e saj është një tmerr i vërtetë, por nuk mund të mbyllë sytë deri sa ta kenë lënë forcat plotësisht, e të mos mundet të ndihmojë të birin.

4- Një motër në shpëtimin të vëllait

Është krejt ndryshe nga familjarët e tjerë. Ajo është shumë e re, energjike dhe mjaft e zgjuar. Në fakt nuk është nënë, por është motra e vëllait adoleshent i cili duket se nuk i ka shpëtuar vesit të helmit të bardhë. Në qendrën “Aksion Plus” pos afrimitetit që ka nëna dhe babai mund të gjesh edhe sakrificat që bën motra për vëllain. E.D është 22 vjeçare dhe shpejt diplomohet në Fakultetin e Drejtësisë, por duket se halli më i madh i saj tashmë është vëllai i vogël 15 vjeçar M.D i cili duket se ka zgjedhur një rrugë shumë të gabuar. Kërkon dhe bën të pamundurën që ta shkëpusë njëherë e përgjithmonë nga kthetrat e drogës. “E di që im vëlla është adoleshent dhe gabimet e moshës mund t’i falen, por shpresoj me gjithë zemër që t’ia dalë”- thekson ajo tek iu lutet punonjësve të “Aksion Plus” që ta kenë sa më kujdes gjatë trajtimit me metadon. Madje përpjekjet e studentes së Juridikut shkojnë deri

aty sa vendos për ta shoqëruar vetë të vëllain çdo ditë në marrjen e metadonit, dhe përpiket që ta shmangë nga shoqëria e përdoruesve të tjerë. “Përpikem të jem e përpiktë me oraret kur vëllai duhet të trajtohet me metadon. Ai është pika ime e dobët dhe e dua më shumë se këdo tjetër në botë”, - pohon ajo tek rrëfen se prindërit e saj po përjetojnë situata të vështira tashmë që e dinë se i vëllai është përdorues droge.

Megjithatë adoleshenti duket se është me fat pasi motra e tij nuk kujdeset vetëm që ai të marrë në mënyrë korrekte trajtimin me metadon dhe e shoqëron çdo ditë, por ajo është edhe njohëse shumë e mirë e ligjeve, dhe kritikon veprimet e forcave të rendit të cilët nuk zbatojnë ligjin, dhe ndalojnë pa asnjë shkak përdoruesit e drogës, madje edhe i torturojnë ata. “Nuk mund të harroj kurrë ankthin që përjetuam unë dhe familja ime një natë që im vëlla nuk u kthye në shtëpi. E kërkuam gjithandej dhe më në fund mësuam që ndodhej në një nga komisariatet e Tiranës. Arsyeja ishte ndalimi i tij me një dozë konsumi ditor. Problemi nuk qëndron vetëm këtu, por ai ishte goditur nga policia duke i shkaktuar lëndime dhe plagë”, - pohon studentja duke theksuar se këto veprime të policisë janë në kundërshtim me ligjin sepse asnjë i akuzuar apo i dyshuar qoftë edhe për vepra kriminale nuk duhet të lëndohet nga forcat e rendit.

Specialistët

Sipas mjekut të “Aksion Plus” vetëm 20% e vartësve të drogës i kthehen normalitetit

Rrugë pa kthim. Madje kjo rrugë i dërgon në destinacionin më fatkeq, që as nuk mund ta kishin menduar. Degradim deri në ushtrim prostitucioni vetëm për të përfituar pak nga pluhuri i bardhë, që në këmbim të kënaqësive të momentit u shkatërron jetën. Ky është rezultati që përfitojnë pjesa më e madhe e personave që përdorin drogë. Doktorin Kahreman Harxhi, i cili prej 5 vitesh pret përdoruesit e drogës pranë Qendrës “Aksion Plus” për t’i trajtuar me metadon, thekson për gazetën “Shekulli” se vetëm 20 për qind e tyre arrijnë t’i kthehen normalitetit, ndërsa pjesa tjetër mbeten vartës të drogës pavarësisht përpjekjes së madhe për ta lënë atë. Ndërsa 25-vjeçari J.P., i cili po trajtohej në këtë qendër, tregoi se si kishte rënë pre e drogës dhe përpjekjet që po kalon ai për ta lënë vesin e mallkuar.

Degradimi

Bëhen vartës të drogës e për ta siguruar atë bëjnë gjithçka. I transformon jo vetëm nga ana fizike, por edhe në karakter. Kështu u shpreh Dr. Harxhi, i cili theksoi se në shumicën e rasteve, vartësit e drogës jo vetëm që nuk mund ta lenë atë, por degradohen deri në atë pikë, sa nuk njohin më asnjë normë e moral. “Nga praktika jonë 5-vjeçare, vetëm 20 për qind e të trajtuarve i janë kthyer jetës normale, ndërsa pjesa më e madhe e kanë rifilluar përsëri drogën pasi e kanë patur të pamundur për ta lënë atë pavarësisht përpjekjeve të mëdha që kanë bërë”, - pohon Harxhi. Sipas tij, droga tek këta persona ka lënë shumë pasoja, duke i transformuar ata, edhe sa i takon karakterit, pasi bëhen të ashpër duke krijuar probleme me familjen dhe shoqëri. “Kulmi i sjelljes së tyre, që nga vjedhjet, mashtrimet e deri tek prostitucioni vetëm për të siguruar lekët për të marrë drogë”, - pohon Harxhi. Ndërsa vartësi i drogës J.P., i cili po trajtohet pranë “Aksion Plus” me metadon, thekson se është prej 5 vitesh përdorues i rregullt i drogës dhe se po bën maksimumin për ta lënë atë. “Dikur nisa të pi

hashash për kuriozitet dhe kënaqësia më shtyu të përdor edhe heroinë. Tashmë jam i varur prej heroinës, dhe po vuaj deri në vdekje për ta lënë, por duket se më ka mposhtur”, - thotë ai.

Përhapja

Tragjike, por e vërtetë. Përdoruesit e drogës po shtohen gjithnjë e më shumë, ndërsa strukturat shtetërore nuk marrin asnjë masë për frenimin e këtij fenomeni. Që në kohën kur u krijua Qendra e Toksikologjisë, pranë Spitalit Ushtarak, ka mbetur e vetmja me 15 shtretër që trajton rastet akute apo mbidozat. Fenomeni po kthehet në tragjedi për mijëra të rinj dhe familjarë, ndërkohë që mungojnë strategjitë e mirëfillta për rehabilitimin e tyre. Përdoruesit e drogës fillojnë nga moshat minorene 15 vjeç e deri tek të rriturit rreth të 45-ve.

Fenomeni

Ulet mosha e përdoruesve të drogës, rast edhe një 9-vjeçar

I gjen ngado, në periferi dhe në qendër. Tashmë, vendet e tyre të preferuar për të marrë helmin e “bardhë” nuk janë vetëm qendrat e braktisura, por edhe shtëpitë e tyre. Ndërkohë, tragjedia e këtij fenomeni është se mosha e përdoruesve të drogës po ulet, duke përfshirë edhe adoleshentët. Një vëzhgim gazetaresk nëpër vendet ku përdoruesit marrin mallin çdo ditë, ofronte pamje drithëruese.

Shiringa të hedhura pa më të voglin kujdes, ende të freskëta nga vakti i radhës. Diku afër një lugë që u shërben për të përgatitur drogën, apo edhe sende të tjera që u nevojiten për të marrë pluhurin, i cili u dëmton jetën çdo ditë e më shumë. Kjo është një pjesë e panoramës që të ofrohet nëpër godinat e braktisura dhe të vjetra, qendra këto ku strehohen përdoruesit e drogës sa herë marrin malin dhe që i gjen ngado, që nga qendra deri në periferitë e Tiranës. Në fakt, sot po vihet re një fenomen i ri, pasi po pakësohen pikat dhe qendrat në terren, si godinat e vjetra, godinat e braktisura dhe vendet e fshehta, sepse po behën ndërtime dhe po shfaqet fenomeni i injektimit në banesa.

Tendencat

Kategorisë së përdoruesve të drogave po i shtohen gjithnjë e më shumë edhe femrat. Por ato maskohen më shumë për hir të mentalitetet shqiptar. Sipas mjekut të qendrës “Aksion Plus”, femrat janë më vështirë të identifikohen, pasi në çastin që zbulohen nga familja se janë përdoruese, mbahen larg vëmendjes së njerëzve. Por, sipas tij, ajo çka e bën situatën më shqetësuese është fakti se po ndeshen gjithnjë e më shumë përdorues droge tek moshat e reja. Kemi histori që e kanë filluar drogën që 11 vjeç, dhe është ky personazhi këtu që e shikoni në foto. I ka vdekur edhe vëllai nga përdorimi i drogës. Pra, po vihet re një fenomen që po ulet mosha e përdoruesve të drogave.

Ish-përdoruesit, urë lidhëse me përdoruesit e drogës

Bashkëpunojnë me ish-përdorues të drogave për të bërë një urë lidhëse mes aktivistëve të “Aksion Plus” dhe përdoruesve të drogës. Dalin në terren çdo ditë dhe u shpërndajnë shiringa për të shmangur ndonjë infeksion të mundshëm nga shiringat e njëri-tjetrit që përdorin për injektim. Projekti ka mjekë, psikologë, punonjës socialë dhe ish-përdorues. Në terren punojnë dy ish-përdorues që bëjnë mundësimin e lidhjes me përdoruesit e drogës.

Shpenzimet e përdoruesve dhe rreziqet që sjellin ata

Transmetimi i infeksionit HIV tek përdoruesit e drogës është tipik përmes shkëmbimit të aqve apo shiringave që përdoren për injektimin e drogave ilegale. Ky është edhe qëllimi kryesor i shpërndarjes së shiringave të pastra në terren. Përdoruesit e drogave me injektim janë “urë lidhëse” midis transmetimit të infeksionit HIV tek grupet e tjera me risk dhe popullata në përgjithësi. Pjesa më e madhe e përdoruesve intravenozë të drogës janë meshkuj (rreth 91% e atyre që morën pjesë në studim) dhe moshë mesatare e fillimit të drogës me injektim është rreth 18 vjeç. Për sa i përket edukimit, dominojnë ata me arsim 8-vjeçar; 1/3 me arsim të mesëm dhe pak prej përdoruesve kanë arsim të lartë; rreth 16% e tyre aktualisht janë duke ndjekur shkollën. Në lidhje me punësimin, 68% e tyre raportojnë që nuk kanë një vend pune ose sapo e kanë humbur atë për shkak të marrëdhënieve të tyre me përdorimin e drogave ilegale. Ndërsa, sa u takon shpenzimeve për të blerë mallin e përditshëm, një përdorues droge shpenzon mesatarisht 2000-3000-3500 lekë në ditë për të blerë drogën.

Policia *****

Parandalimi i përdoruesit e drogës, jo sanksione, por shërbime.

Parandalimi i uljes së numrit të përdoruesve të drogës nuk kërkon sanksione të rrepta por shërbime në dobi të tyre. Madje legjislacioni për përdoruesit e drogës duhet të ndryshojë pasi lufta për reduktimin e përdoruesve të drogës nuk po rezulton efektive. Kështu u shpreh njëri nga hetuesit e antidrogës pranë Drejtorisë së Policisë së Tiranës i cili shpjegon mënyrën e punës së policisë në luftë përball fenomenit të drogës.

E.B: Si funksionon puna e policisë përballë përdoruesve të drogës?

Kur personat kapen me sasi lëndësh narkotike që janë për përdorues nuk dënohen, por unë si polic jam i detyruar ta arrestoj.

E.B: Sa është doza për përdorim vetjak.

Në fakt nuk ka ndarje. Kjo nuk është e përcaktuar. Kështu që nëse unë e kap personin me një sasi të vogël jam i detyruar ta arrestoj ose ta procedoj në gjendje të tillë. Pastaj u bëjmë analizat përdoruesve me anë të urinës për të parë nëse është përdorues dhe çfarë lëndësh ka përdorur, dhe kur e ka përdorur për herë të fundit drogën. Në bazë të këtyre të dhënave dërgoj një vendim tjetër ku kërkoj që të përcaktohet nëse sasia e sekuestruar është mbi dozën që duhet të mbajë një përdorues droge. Këtë e vendos Mjekësia-ligjore pasi ka mjekë dhe ekspertë që e vendosin nëse është doza e mjaftueshme për përdoruesin. Në këto raste kur doza është e normale për një përdorues çështja pushohet dhe nuk procedohet.

E.B: Në këto raste arrestimi sjell rritjen apo zvogëlimin e përdoruesve të drogës?

Në gjithë botën numri i përdoruesve të drogës rritet.

E.B: Cila është mënyra më e mirë që të adresosh adoleshentin e arrestuar për sasi të vogla përdorimi të drogës, pra cila është rruga më e mirë që duhet të ndiqet nga policia në raste të tilla?

Mendoj se legjislacioni duhet të ndryshohet. Por ka edhe aspekte të tjera pasi duhet të shtohen strukturat që duhet të ndihmojnë këta përdorues droge dhe këtu duhet të futen sidomos financimet e shtetit. Mendoj se në vendin tonë tashmë është problem më i madh droga se virusi HIV/AIDS

E.B: Cila mendoni se është mënyra më e mirë për një ripërsëritës droge, pra kur ata kanë kryer të njëjtën vepër më shumë se dy herë dhe janë kapur nga ju. Cila është mënyra më e mirë që ky person të mos vazhdojë të jetë ri përsëritës droge?

Për ne është sanksioni dhe këtu ritheksoi se duhet riparë legjislacioni. Nuk mendoi se nuk duhen sanksione më të rrepta por duhet të ketë më shumë shërbime për përdoruesit e drogës. Kështu mund të parandalohet më mirë. Kështu mund të largohen më shumë nga rruga e përdorimit të drogës.

Ofruesit e shërbimeve - Psikologu

[Ishte punonjëse seksi shtatzënë dhe i refuzohet ndihma mjekësore](#)

Përdoruesit në përgjithësi janë një popullatë mjaft vulnerabël jo vetëm në aspektin shëndetësor por edhe psikosocial. Për shkak të abuzimit me substancat, përdoruesit mbartin një sërë problemesh fizike dhe mendore. Në këtë aspekt një pjesë e mirë e tyre nuk marrin trajtimin e duhur shëndetësor pasi ata diskriminohen për shkak të vetë faktit që janë përdorues të substancave narkotike. Kështu e nis shpjegimin e psikologjia e Qendrës Aksion Plus, Andia Meksi e cila thekson se trajtimi me metadon kërkon një angazhim të përditshëm në qendrat që e ofrojnë atë. Përdoruesve u ofrohet edhe shërbimi psikologjik përveç atij mjekësor.

E.B: Por sa ka ndikuar shkelja e të drejtave të përdoruesve të drogës mbi psikologjinë e tyre?

Psikologjia këtë shpjegim e jep me argumentin se shkelja e të drejtës për ofrimin e terapisë qofte kjo mjekësore apo sociale ndikon drejtpërsëdrejti në suksesin e të qenit i “pastër” të shmangies së relapsit pra rikthimit të përdorimit të substancës në rastin kur një person arrin të shkëputet nga përdorimi i saj. “Në shumë raste edhe në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore; psh kur një përdoruesi të heroinës me shiringë nuk i kryhen analiza falas në mënyrë të rregullt çdo 6 muaj nga ana e sistemit shëndetësor, ky i fundit rrezikon që te preket nga Hepatiti B dhe C, HIV- AIDS apo edhe sëmundje të tjera të gjakut”, pohon Andia Meksi duke shtuar se nuk mjafton vetëm ofrimi i shiringave të pa përdorura për këtë kontigjent përdoruesish, por edhe një mbikëqyrje dhe kujdes vazhdueshme mjekësor dhe social.

E.B: Po cili është rasti më i veçantë që ka trajtuar gjatë eksperiencës së psikologes?

Sipas saj rastet kanë qenë të shumta sidomos ato të cilat kishin të bënin me refuzimin e trajtimit mjekësor nga ana institucioneve publike shëndetësore. “Për të përmendur një rast konkret, një vajzë

e cila ishte në muajin e 9 të shtatzanisë, ju refuzua ndihma për të asistuar nga stafi mjekësor gjatë lindjes për arsye se ajo ishte një punonjëse seksi dhe me shume te ngjare edhe përdoruese droge”, pohon psikologja duke shtuar se edhe pasi ata si staf ndërhymë duke kërkuar me insistim që kësaj vajze të re ti ofrohej ndihma e nevojshme, mjekët dhe personeli i mesëm nuk denjonin që ta pranonin të shtrohej në repartin e lindjes në maternitet pasi sipas tyre përbënte rrezik për nenat e tjera të shtruar në atë repart. Vetëm njoftimi me gazetarët për të denoncuar këtë akt jo njerëzor nga ana e mjekëve sipas saj do ti bindë të pranojnë pa vullnetin e tyre që vajza të shtrohej në maternitet dhe ti ofrohej ndihma e nevojshme mjekësore.

Sipas psikologes femrat janë më të ndjeshme dhe më të paragjykuar në aspektin social se meshkujt, kjo bën që ato të jenë më të tërhequra karshi kërkesës për ndihmë dhe trajtim për varësin e tyre. “Të dhënat statistikore dhe eksperiencat klinike tregojnë se numri i femrave që janë evidentuar si përdoruese dhe trajtuar është mjaft i vogël, por kjo jo detyrimisht reflekton realitetin pasi për shkak të frikës ndaj diskriminimit dhe izolimit social që ato kanë, tregojnë se ato nuk kanë besim në sistemin shëndetësor aktual”, pohon Andia Mexsi.

Ofruesit e shërbimeve – punonjësi social

“Përdoruesve të drogës iu shkelen të drejtat çdo ditë”

Punën me përdoruesit e drogës e konsideron të bukur dhe të vështirë njëkohësisht. Përballet çdo ditë jo vetëm me problemet e vetë përdoruesve por edhe të familjarëve të tyre. Enkeljda Ngjelina është psikologe e cila ka vite që punon me këtë target grup dhe mendon se gjuhën e tyre e njeh shumë mirë çka e ndihmon atë në punën e saj të përditshme.

“Të punosh me përdoruesit e drogës është një punë sa e bukur dhe e vështirë, e bukur se ndihmon njerëzit si dhe familjarët e tyre dhe e vështirë se përballesh çdo ditë me problemet e tyre të cilat fatkeqësisht nuk mund të zgjidhem vetëm me ndihmën e një shoqate apo një tjetre”, pohon psikologja duke shtuar se problemi i përdoruesve është një problem social, ekonomik dhe se i përket fushës së shëndetit publik dhe tashmë adiksi mund të konsiderohet si një sëmundje kronike që ka nevojë në vazhdimësi për trajtim mjekësor e mbështetje sociale.

Sipas saj në përgjithësi fenomeni i drogës është i ri për realitetin shqiptar megjithëse ka pothuajse 15 vjet që është hyrë në shoqërinë tonë mund të themi se të drejtat e tyre shkelen çdo ditë dhe diskriminimi dhe paragjykimi që shoqëria shqiptare ka për këto grupe vulnerable është i madh dhe se aksesit në shërbimet shëndetësore, aksesit në shërbimet e tjera si punësimi, strehimi, edukimi.

Ndërkohë ajo shpjegon se nuk ka një ndarje gjinie për shkeljen e të drejtave të përdoruesve të drogës por sipas saj në këtë rast femrat e kanë më të vështirë për vetë realitetin shqiptar që janë akoma dhe më të paragjykuara për vetë faktin që janë femra. Gjithashtu ajo shpjegon se në Qendrën Aksion Plus trajtojnë mbi 100 përdorues në muaj dhe mund të themi se mbi 30 % e tyre të cilët deklarohen se janë përdorues heroine iu shkelen të drejtat. “Ndihma që ne ofrojmë konsiston në advokaci, trajnime me median, informacion në lidhje me të drejtat e tyre, ndihmë ligjore falas, mundësi punësimi dhe akses në shërbimet e tjera shëndetësore”, - pohon Enkeljda Ngjelina.

Ofruesit e shërbimeve - drejtori

“Kanë zgjedhur rrugën e gabuar, por ne duhet t’i mbështesim”

Janë të vështirë, sillen në mënyrë të papranueshme dhe mashtrojnë sa herë t’u jepet rasti. Megjithatë ata janë sërish pranë tyre dhe mundohen me çdo kusht t’i largojnë nga rruga e gabuar që kanë zgjedhur. Ky është misioni jo vetëm i drejtuesit të Aksion Plus, Genci Muçollari i cili ka vite që e drejton këtë qendër, por edhe i gjithë stafit të kësaj qendre. E ndonëse përdoruesit e drogës kanë shumë probleme ajo çfarë është shqetësuese për Muçollarin është fakti se të drejtat e tyre shkelen kudo.

E.B: Ju punoni çdo ditë me përdoruesit e drogës, cilat janë disa nga vështirësitë e punës që keni me këtë kategori?

Përdoruesit e drogës hasin shumë vështirësi në jetën e tyre, si dhe në marrëdhëniet me të tjerët. Ata shpesh detyrohen të sillen në një mënyrë të papranueshme për pjesën tjetër të familjes dhe shoqërisë, dhe kjo i detyrohet në masën më të madhe përdorimit të substancave të paligjshme. Ka shumë raste kur përdoruesit bëhen agresivë me stafin që punon në qendër, ka raste kur mashtrojnë për ta marrë terapinë me vete dhe pastaj abuzojnë, ka raste kur keqtrajtojnë familjarët e tyre, apo me keq, kur keqtrajtohen nga policia, apo bashkëmoshatarët e tyre, dhe e gjithë kjo ndikon në marrëdhëniet e tyre me të tjerët, si dhe vështirëson punën e qendrës sonë. Në këto situata puna e këshilluesit apo psikologut ndikon për të zbutur këto efekte në planin individual dhe shoqëror.

E.B: A vini re që të drejtat e tyre shkelen nga të tjerat dhe kush i shkel më shumë këto të drejta?

Të drejtat e përdoruesve shkelen pothuajse çdo ditë, nga persona të caktuar, struktura shtetërore, policia dhe sistemi shëndetësor. Një përdorues e ka të vështirë, thuajse të pamundur të punësohet, apo në rastin kur punëdhënësi mëson se një person përdor drogë, ai e pushon nga puna atë. Ka shumë raste kur persona që përdorin drogë apo dhe klientë të qendrës iu refuzohet shërbimi shëndetësor, sidomos personave nga komuniteti Rom dhe jevgj. Kemi konstatuar raste dhune nga policia pa motive të argumentuara apo të mbështetura në ligj; bëhen presione të jashtëligjshme nga agjentë të policisë për të marrë informacione, apo për të rekrutuar “spiunë” mes përdoruesve.

E.B: Si dhe sa ndikon shkelja e të drejtave të përdoruesve të drogës mbi këta të fundit?

Shkelja e të drejtave të përdoruesve ndikon mbi jetën e tyre dhe të personave përreth. Ata bëhen më agresivë, më të mbyllur, vetë-izolohen, kanë një shkallë të ulët vetë-vlerësimi apo vetë-shkatërrimi, bëhen depresive dhe janë të prirur për akte dhe vepra antisociale. Në të kundërt mbështetja psiko-sociale, krijimi i një mjedisi miqësor dhe dhënia e shërbimeve që zvogëlojnë dëmin që vjen nga droga, të gjitha këto janë faktorë pozitivë që ndikojnë direkt në mirëqenien e tyre psiko-fizike, dhe në përmirësimin e marrëdhënieve të tyre me të tjerët.

E.B: Më thoni një nga rastet më të veçanta që jeni ndeshur gjatë punës tuaj kur një përdoruesi droge i janë shkelur këto të drejta?

Femrat apo meshkujt i përjetojnë më shumë rastet e shkeljes së të drejtave të tyre?

Femrat janë ato të cilave iu shkelen më shumë të drejtat. Por dhe anëtarë të grupeve të marginalizuara Romët apo LGBT (Lezbike, Meshkuj që bëjnë seks me meshkujt, biseksualë dhe transvestitë). Këta individë pësojnë një dhunë thuajse permanente, gjë që ka ndikim negativ në shëndetin e tyre mendor dhe fizik.

E.B: A ofroni ju ndihmë konkrete për përdoruesit kur iu shkelin të drejtat?

Ndihma jonë konsiston në këshillimin e rasteve të shkeljes së të drejtave, apo dhunimeve që na raportohen. Gjithashtu ne kemi kontaktuar struktura të Policisë për të parandaluar rastet e dhunës ndaj tyre. Kemi një bashkëpunim me shoqata të drejtave të njeriut, rrjete ndërkombëtare, dhe struktura të tjera ndërkombëtare për të adresuar siç duhet dhe mbështetur rastet e dhunës.

Ofruesit e shërbimeve - Psikologu

“Përdoruesve të drogës iu mohohet shërbimi shëndetësor”

Kemi të bëjmë me një pjesë të rinisë shqiptare e cila ka nevojë për mbështetje dhe përkrahje. Këtë përkufizim jep psikologu i Aksion Plus, Erlind Plaku për përdoruesit e drogës. Sipas tij çdo rast që paraqitet pranë shërbimit të tyre është unik dhe duhet trajtuar si i tillë nga mjeku edhe psikologu. “Shumë shpesh çrregullimi i abuzimit me substancat është i shoqëruar edhe me diagnozë të dyfishtë që mund të jetë kryesisht çrregullimi antisocial i personalitetit ose bonderlinë. Pra kemi të bëjmë me persona jo-konformistë që janë të irritueshëm, nervozë ndonjëherë paraqesin shenja agresiviteti kryesisht në lidhje me terapinë e metadonit”, pohon ai.

Sa i takon shkeljes së të drejtave të përdoruesve të drogës psikologu pohon se kanë pasur raste konkrete. “Kemi pasur shume raste konkrete kur të drejtat e përdoruesve shkelen gjatë raportimeve të vetë klientëve të metadonit. Kryesisht nga informacionet që ne kemi marrë këto të drejta janë shkelur me shumë nga institucione si për shembull, ai policor edhe shëndetësor”, - pohon psikologu Erlind Plaku duke shtuar se kanë pasur raste të individëve me probleme shëndetësore si, abceset dhe nuk kanë marrë shërbime nga këto institucione. Një pjesë e tyre i përkasin komunitetit Rom (përqindja më e madhe e tyre përdorues intravenoze të heroinës), i cili është me shumë i paragjykuar dhe i diskriminuar dhe në disa raste nuk kanë marrë shërbimin e duhur shëndetësor.

Por si dhe sa ndikon shkelja e të drejtave të përdoruesve të drogës mbi këta të fundit...?

Sipas psikologut kemi të bëjmë me një target grup i cili ka probleme sociale si në familje dhe shoqëri për shkak të abuzimit me drogat. Ai thekson se kanë të bëjnë me persona të cilët si pasoje e abuzimit me substancat janë të papune, kanë probleme ekonomike, probleme të socializimit me të tjerët dhe të integritimit në shoqëri. “Në çastin kur këtyre personave u mohohen disa të drejta ata e konsiderojnë veten si të përjashtuar që rrjedhimisht sjell nxitjen e ndjenjave të izolimit social. Ata mbyllën në vetvete, humbasin besimin dhe motivimin për të ecur përpara që janë disa nga temat kryesore që trajtohen gjatë seancave të këshillimit”, pohon psikologu Erlind Plaku.

Pikërisht një nga rastet më të veçanta që ka përjetuar psikologu është rasti i nje djali 27 vjeçar te cilit i janë mohuar të drejtat e tij nga ana e organeve policore. “Ai është vënë nën një presion të rëndë

psikologjik nga këta te fundit gjatë marrjes në pyetje për një kohë të gjatë duke e dhunuar psikologjikisht për të marrë informacione. Personi në fjalë me tipare depresive ka dashur që të bëje publike në media dhunën psikologjike të ushtruar ndaj tij dhe në momentin në të cilin atë nuk e besoi njeri, tentoi që të vriste veten duke i vënë zjarrin”, tregon Erlind Plaku duke shtuar se ky veprim u bë në një nga rrugët më të frekuentuara në Tiranë. Sipas tij rasti mendoi se ishte e vetmja mënyrë për të denoncuar atë që ndodhi. Është një rast i cili vazhdon të marrë shërbim në qendrën e metadonit dhe ndiqet me kujdes të veçantë.

Të drejtat Njerëzore dhe Përdoruesit e Drogave

Të drejtat njerëzore të përdoruesve të drogave dhunohen rregullisht në gjithë Botën. Stigma dhe diskriminimi renditen në shkaqet kryesore të abuzimit të të Drejtave Njerëzore për Përdoruesit e Drogave - fenomen i cili ndihmon në rritjen dhe përhapjen e HIV/AIDS midis përdoruesve të drogave. Përdoruesit e drogave janë qytetarë me të drejta të plota dhe kushte shëndetësore specifike, dhe jo kriminelë të papërgjegjshëm.

Të Promovosh, Mbrosh dhe të Realizosh të Drejtat Njerëzore do të thotë:

- Të ndihmosh njerëzit të kalojnë **paragjykimet, paditurinë dhe frikën**, të cilat i udhëheqin drejt shkeljes të të drejtave të të tjerëve, **nëpërmjet edukimit** mbi të drejtat e njeriut dhe aspekte të tjera jetësore.
- Të mbështesësh dhe të mbrosh njerëzit, të drejtat e të cilëve janë **kërcënuar** ose **dhunuar** si dhe të bëhet kompensimi dhe shpërblimi në rastin e shkeljes së të drejtave të njeriut.
- Të sigurosh dhe të krijosh kushte të përshtatshme për **realizimin** e të Drejtave Njerëzore, sidomos për grupet më në nevojë.

Disa nga të Drejtat Njerëzore më të dhunuara për Përdoruesit e Drogave:

E drejta Shëndetësore

- Mohimi apo mungesa e aksesit, përshtatshmërisë dhe cilësisë të trajtimeve më efektive për përdoruesit e drogave siç janë terapitë mbajtëse me metadon, burprenorfinë apo zëvendësues të tjerë, si dhe mungesa e procedurave diagnostikuese dhe trajtuese.
- Mungesa e aksesit, përshtatshmërisë dhe cilësisë të shërbimeve të Reduktimit të Dëmit (RD), kryesisht të shiringave të pastra dhe mjete të tjera sterile për injektimin e drogave si dhe shërbime të tjera të RD.
- Mungesë e aksesit të qendrave të specializuara terapeutike për trajtimin e përdoruesve të drogave.
- Mungesë e Qendrave të Këshillimit e Testimit Vullnetar për HIV/AIDS, specifikisht për përdoruesit e drogave.
- Mungesa totale e këtyre shërbimeve në shkallë vendi dhe mos përmbushja e nevojave jetësore për këtë grup vulnerabël kundrejt HIV/AIDS.

Pavarësia, siguria dhe liria e lëvizjes

- Testim i detyrueshëm për HIV dhe infeksione të tjera të transmetueshme nga gjaku.
- Të qenurit objekt i kontrolleve të vazhdueshme nga ana e policisë, objekt i akuzave dhe ndjekjes penale për shkak të përdorimit të drogës.
- Ndërprerja e Terapisë Mbjtëse me Metadon (TMM) kur udhëtojnë drejt shteteve legjislativoni i të cilëve nuk e lejon përdorimin e TMM.
- Të futurit në karantinë, izolim apo veçim - psh futja në karantinë e përdoruesve të drogave HIV pozitiv, dhe veçimi i të burgosurve HIV pozitiv në qeli të ndryshme.
- Të qenurit vulnerabël kundrejt infeksionit dhe sëmundjes vdekje-prurëse të HIV/AIDS për shkak të mohimit, ndalimit apo reduktimit të aksesit të shërbimeve të përshtatshme për parandalimin e HIV/AIDS.

Subjekt i trajtimeve ç'njerëzore dhe degraduese

- Shfrytëzimi i kushteve të brishta shëndetësore si rezultat i varësisë dhe krijimit të gjendjes së abstinencës e manifestuar me simptoma specifike, për të marrë informacione të ndryshme nga ana e policisë në lidhje me trafikimin e drogave.
- Dhunim i të drejtës mbi jetën, integritetit dhe dinjitetit të personit nëpërmjet mohimit të trajtimit të përshtatshëm nën kushtet e varësisë sidomos në ambientet e paraburgimit, mohim ky që shpesh u kushton jetën përdoruesve të drogave.
- Të qenurit subjekt i trajtimeve të detyrueshme detoksifikuese duke zgjatur mbajtjen e përdoruesve në ambientet e paraburgimit apo burgimit, pa zhvilluar seancat gjyqësore të nevojshme, apo mbajtjen në kushte degjeneruese të përdoruesve në këto ambiente.
- Pjesëmarrja apo të qenurit pjesë e eksperimenteve mjekësore apo provimin e medikamenteve të reja pa kuptuar plotësisht procedurat, apo dhe pasojat e eksperimentit si dhe pa marrë lejen apo miratimin e personit.

Mbrojtje e barabartë para ligjit

- Mungesa e kuadrit ligjor apo mospërshtatja e tij në përmbushjen e nevojave që ata paraqesin për realizimin e shërbimeve shëndetësore dhe psiko-sociale për Përdoruesit e Drogave.
- Mungesa ose mospërshtatja e strategjive, dokumentave politike dhe planeve të implementimit, kjo në varësi të prioriteteve të vendosura nga shteti.
- Mos sigurimi i mundësive për këshilla apo shërbime ligjore

Subjekte të Stigmës dhe Diskriminimit

- Stigma dhe diskriminimi janë shkaqet kryesore që mbajnë përdoruesit e drogave larg shërbimeve parandaluese për HIV/AIDS dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në përhapjen e infeksionit në këtë grup njerëzish.
- Qëndrimet e shtetit dhe përgjigja që i jepet problemit të drogave shpesh ndikohen nga stigma dhe diskriminimi që mbështjell këtë problematikë.
- Mungesë e mundësive për pasjen e informacioneve të kuptueshme të cilat bëjnë të mundur që njerëzit të bëjnë zgjedhje të informuara në jetën e tyre.

- Pushim nga puna apo diskriminim në vendin e punës për shkak të përdorimit të drogës apo të statusit të tyre ish-përdorues
- **Mungesa e kuadrit ligjor për një trajtim të posaçëm në drejtim të përfitimeve** nga sigurimet shoqërore apo përfitime të tjera nga skemat e mbrojtjes sociale për shkak të natyrës kronike të sëmundjes së tyre, varësisë ndaj drogave.

Privatësia

- Mungesë konfidencialiteti apo deklarim i statusit si “*Përdorues Droge*” pa pëlqimin e personit nga stafi mjekësor, media e shkruar dhe ajo vizive, etj.
- Trajtimi i detyrueshëm i përdoruesve pa pëlqimin e tyre apo futja me forcë për kryerjen e shërbimit ushtarak.
- Mungesë konfidencialiteti apo deklarim i rezultateve të testit mbi HIV, pa pëlqimin e personit kundrejt autoriteteve shëndetësore si dhe subjekte të tjera.

Ligjet kombëtare për drogën

Ne lidhje me legjislacionin nderkombetar Shqiperia aderon ne tre Konventat e Shteteve te Bashkuara ne fushen e droges.

Ne baze te neneve 283, 284, 285 dhe 286 te Kodit Penal Shqiptar, sanksione te ndryshme kunder trafikimit, prodhimit, perpunimit, shperndarjes, transportimit, mbajtjes dhe shitjes se droges dhe substancave psikotropike (pa dallim) jane parashikuar (5-10 vjet burgim per prodhim, shitje, shperndarje dhe posedim dhe (7-15 vjet per trafikim te droges “import-export”). Keto sanksione jane me te ashpra nese shkelja behet ne bashkepunim ose nga organizata kriminale. Sanksione penale jane parashikuar edhe per kultivim te paligjshem te bimeve narkotike (3-7 vite burgim) dhe trafikimin apo derivate paraprirese te saj (3-7 vite burgim). Posedimi i nje “doze ditore” te droges per perdorim personal nuk eshte e denueshme. Shume shpesh sasia e droges se konfiskuar mund te influencojë gjyqtarin te vendose midis denimit minimal dhe maksimal te parashikuar per shkeljen.

Qe nga 2004, ne Kodin Penal Shqiptar, jane bërë shume permiresime te rendesishme, te tilla si, ndryshimet persa i perket “Organizatave Kriminale” (neni 333) “Grupet Kriminale te Organizuara” (neni 333/a). Po keshtu, ndryshime te medha jane bere edhe ne Kodin Shqiptar te Proçedures Penale, ne lidhje me burimet investiguese speciale; sipas ketyre ndryshimeve prokurori ka te drejte te lejoj aplikimin e burimeve te ndryshme investiguese siç mund te jene: vëzhgime, kapje ne rruge, lirime me kusht, operacione sekrete, etj, te cilat se fundmi kane rezultuar si shume te dobishme ne perçarjen e rrjeteve kriminale te trafikimit te droges.

Ligji nr. 8750 i dates 26 Mars 2001 “Per parandalimin dhe luften kunder trafikimit te paligjshem te drogave narkotike dhe substancave psikotrope” parashikon standartet per parandalim dhe luftim te trafikimeve ilegale te drogave dhe derivate te tyre. Ketu jane perfshire me teper detaje te metodave speciale investiguese te tilla si “ndjekje te rreme”, “lirime me kusht” dhe “infiltrime” dhe “agjente

sekret”. Gjithashtu, ne kete ligj eshte parashikuar krijimi dhe funksionimi i Komitetit Kombetar te Koordinimit te Luftes Kunder Drogenes.

Ligji nr. 7975 i dates 26 Korrik 1995 i emertuar “Per substancat narkotike dhe psikotrope”, i amenduar nga Ligji nr. 9271 i dates 9 Shtator 2004 dhe Ligji nr.9559 i dates 8 Korrik 2006, parashikon rregullat e prodhimit, perpunimit, importimit, eksportimit, tregtimit, kontrollimit dhe mbajtjes se drogave narkotike dhe substancave psikotrope.

Ligji nr 8874, date 29 Mars 2002 “Per kontrollin e substancave qe mund te perdoren per perpunim ilegal te substancave narkotike dhe psikotrope” parashikon rregulla per kontrollin e substancave qe shpesh perdoren per perpunimin e substancave narkotike dhe psikotrope, duke synuar parandalimin e devijimit te destinacionit te ketyre substancave. Gjithashtu per shkelesit e ketij ligji jane vendosur sanksione.

Strategjia Kombetare per Drogen

Gjate vitit 2001, nje grup pune nga Ministria e Shendetit (Instituti i Shendetit Publik dhe Sherbimi Klinik i Toksikologjise i QSUT) me mbeshtetjen teknike te eksperteve Çek (nga Projekti i Republikes Çeke dhe Projekti Shqiptar nen Programin PHARE), krijuan draftin e Strategjise se pare Kombetare per Reduktimin e Kerkeses se Drogenes per 2001-2004, i cili u aprovua nga Ministria e Shendetësisë. Kjo strategji u perfshi ne Strategjine tjetër Kombetare kunder Drogenes ne 2004-2010, duke perfaqesuar komponente te tij te kerkeses per reduktim.

Gjate vitit 2004, nje grup pune nder-ministror hartoi draftin per Strategjine Kombetare kunder Drogenes 2004–2010, i cili u aprovua nga Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 292 date 7 Maj 2004. Strategjia eshte gjithperfshirese dhe mbulon si reduktimin e kerkeses per droge dhe reduktimin e sigurimit te drogës. Ky ishte nje produkt i pjesemarrjes se te gjitha institucioneve qeveritare te perfshira ne luften kunder drogës, si dhe organizatave jo-qeveritare dhe me mbeshtetjen e madhe te eksperteve nga organizata nderkombetare te cilat operojne ne Shqiperi. Strategjia njeh natyren serioze te problemeve te drogës ne nivel kombetar dhe nderkombetar dhe pranon se suksesi mund te arrihet vetem nepermjet koordinimit te mbeshtetjes se te gjithë paleve te perfshira, ku mund te permendim qeverine, shoqerine civile dhe partneret nderkombetare. Gjithashtu, me qellim implementimin e kesaj strategjie Kryeministri nepermjet urdherit me nr.156 date 23 Shtator 2004 aprovoi nje plan veprimi multisektorial ku te gjithë institucionet respektive kane marre pergjegjesite e tyre dhe detyra konkrete per periudhen 2004–2010.

Strategjia e Rinise per drogat

Qëllimi dhe Objektivat

Të parandalojë të rinjtë që të përdorin droga – nëse përdorin droga të këshillohen që të mos injektojnë. Aty ku parandalimi dështon, fillon të funksionojë ndërhyrja e quajtur “zvogëlimi i demit apo rreziqeve që lidhen me përdorimin e drogave, sidomos të atyre që injektohen.

Për ata që injektojnë droga:

- Të ulen rastet të injektimit të drogave dhe të zvogëlojnë frekuencën e injektimit
- Të ndalojnë/zvogëlojnë ripërdorimin e shiringave dhe paisjeve të tjera të injektimit
- Të rrisin shkallën e dezinfektimit të ageve dhe shiringave
- Të rrisin mundësinë e pjesmarrjes në programet e trajtimit të drogave (terapi zëvendësuese, apo terapi të tjera rehabilituese pa medikamente).
- Të rrisin përdorimin e prezervativit dhe të metodave të tjera kontraceptive.

Gjithashtu duhet të mbështeten të rinjtë në mbrojtjen dhe promovimin e një jete të shëndetshme pa droga dhe abuzime

Qëllimi afatgjatë është që të krijohet një zinxhir shërbimesh të mbështetur mbi këto tre nivele, duke shtuar edhe disa hallka që mungojnë. Terapia me metadon dhe programme të zvogëlimit të dëmit duhet të shtrihen edhe në rrethe të tjera ku shërbimet për përdoruesit mungojnë pothuaj plotësisht.

Angazhimi

Nga ana e qeverisë lokale dhe qendrore mbetet shumë për të bërë në drejtim të parandalimit dhe abuzimit me drogat. Ende droga nuk konsiderohet një prioritet me rëndësi, por shifrat janë alarmante.

Dihet që në Shqipëri programet e zvogëlimit të dëmit, apo të trajtimit të drogës janë në nivel shumë të kufizuar. Kostot e shumta që duhet të përballojë shteti në të ardhmen do të jenë shumë më të larta, nëse nuk ndërhyhet në kohë. Në përgjithësi për çdo dollar të harxhuar në programet e zvogëlimit të dëmit, qeveria kursen shtatë dollarë.

Angazhimi social dhe shëndetësor duhet të përfshijë disa nivele:

- Promovimin e parandalimit të abuzimit me drogat përmes programeve informative/edukative për fëmijët dhe të rinjtë për rreziqet e abuzimit me drogat.
- Zhvillimin e kurseve të trajnimit dhe shpërndarjen e materialeve informative për studentët, mësuesit, prindërit dhe punonjësit socialë me qëllimin që të aftësohen për të identifikuar dhe për të diagnostikuar herët abuzimin me substancat, dhe se si duhet të trajtohen personat që kanë filluar të abuzojnë me drogat.
- Të mbështeten përdoruesit e drogës në shkollat e mesme, dhe përgjithësisht gjithë moshat e reja për të marrë vendimet e duhura, personale për një “jetë pa drogë”. Nga niveli i informacionit që jepet në shkollat e mesme, të arrihet të ndryshohen apo modifikohen sjelljet që çojnë në pasoja negative mbi shëndetin, dhe problemet sociale të lidhura me përdorimin e substancave psikoaktive.
- Pranë shkollave të mesme të krijohen të quajturat ambjente miqësore për të rinjtë në përgjithësi dhe për ata persona që kanë probleme me drogën, si dhe të vendosen lidhje nga shkolla me mjediset mjekësore për të trajtuar e parandaluar keqësimin e përdorimit të drogës dhe pasojave të saj mbi shëndetin.
- Të përfshihet media për të transmetuar një mesazh domethënës dhe pozitiv për përdorimin e drogave. Gazetarët duhet të përfshihen në programe trainimi se si duhet të organizojnë dhe realizojnë fushata sensibilizimi për popullatën dhe për grupet vulnerabël.

- Organizatat rinore mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ngritjen dhe realizimin e programeve të edukimit dhe këshillimit individual për të inkurajuar integrimin e rinisë në komunitet, për të zhvilluar një stil të shëndetshëm jetese si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për dëmet e shkaktuara nga droga.
- Shërbimet shëndetësore duhet të sigurohen nga shtetit në nivelin e parandalimit parësor, dytësor dhe tretësor. Shërbimet shëndetësore duhet të kordinohen nga të gjithë sektorët, duke u kombinuar me dhënjen e informacionit të duhur për të rinjtë, si dhe duke punuar me personat që ndodhen përreth tyre.
- Të respektohen të drejtat njerëzore për përdoruesit e drogave. Stigma dhe diskriminimi renditen në shkaqet kryesore të abuzimit të të drejtave njerëzore për përdoruesit e drogave - fenomen i cili ndihmon në rritjen dhe përhapjen e HIV/SIDA midis përdoruesve të drogave. Përdoruesit e drogave janë qytetarë me të drejta të plota dhe kushte shëndetësore specifike, dhe jo kriminelë të papërgjegjshëm.
- Të ngrihen grupet e vetëndihmës dhe shoqatat e përdoruesve të drogës. Këto grupe apo shoqata do të jenë të afta të zbatojnë programe për përdoruesit e drogave, si dhe të mbrojnë të drejtat e përdoruesve të drogës.
- Shteti duhet të identifikojë dhe të ofrojë më shumë burime njerëzore dhe materiale për trajtimin e fenomenit të drogave, si dhe në programet e parandalimit. Puna e shoqatave, sado profesionale të jenë ato, përsëri do të mbetet fragmentare, duke adresuar vetëm disa hallka të zinxhirit të gjatë të shërbimeve.

The last story

ORTENCIA'S ROUTINE

A young, thin woman with short hair hurries through Tirana's morning bustle – weaving through noisy, dusty car traffic and crowded, narrow streets. Her bracelets clang with her stride – her heels keep time on the hot asphalt. It's all part of the routine.

Her daily walk takes her down a short pedestrian street along a wall covered in ivy. She takes her usual dive into a shaded opening – disappearing from the surrounding rush. Suddenly, the sound of shouting and car horns fade in the overgrowth – now it's only crunching leaves and grass that reveal her slowed, calm pace.

She follows a path to an old greenhouse, now used as an office. Filing cabinets and desks are wavy shapes through the glass – a dozen “Stop AIDS” posters hang on the windowpanes, bleached by the sun. There are a few people inside; she waves to man stacking papers.

At the backside of the building, she leans over an open window and exchanges smiles with a man, her nurse, sitting inside. He hands her a plastic cup, filled with water and a fizzling little white pill. As she reaches out, the sunshine catches faded purple dots and scratches on her arm.

She downs the drink.

The distant sound of rustling leaves signals the arrival of another patient – and her exit. She heads in the opposite direction, walking past the greenhouse’s entrance: the front door of Aksion Plus.

“Ortencia!” the man stacking papers calls from inside, “Can you come in here, please?” Ortencia enters and swaps greetings with Altin Bashllari, her doctor. He monitors her progress on the Methadone Maintenance Therapy (MMT). Aksion Plus has operated a MMT program since August 2005, with support from GFATM. Bashllari and the staff manage almost 140 patients, including Ortencia.

“Methadone fools my body,” Ortencia explains, motioning to the open window at the back of the greenhouse,
“Every little pill helps me forget about heroin, for a while.”

Daily doses of methadone can help numb a heroin user’s symptoms of withdrawal – their need to have another hit. The stronger the methadone dosage, the less physical desire for heroin.

“Ortencia is on a long-term plan,” Bashllari explains,

“She started treatment three months ago, on a high dose. Every few weeks or so we’ve been lessening that prescribed amount, in hopes of slowly weaning her off methadone completely.” Bashllari asks Ortencia how she is feeling. A few days ago Bashllari decreased Ortencia’s dosage again. She is nervous:

“I don’t want to go back to injecting again. I am staying strong,” she explains. Despite her anxiety, she seems to be adjusting well. Bashllari notes her fuller cheeks and more energetic attitude. A woman calls from outside. Ortencia turns and sees Enkelejda Ngjelina, a social worker, holding an espresso and a packet of Aksion Plus brochures. She joins Ngjelina for conversation outside, at a picnic table hidden in the cool of the ivy overhang. Ortencia’s bright white tank top and jeans almost glow in the shade.

“Enkelejda speaks to me like a friend, not like I am her patient,” Ortencia says. They spend a few minutes catching up with each other almost every day. Their discussion usually revolves around Ortencia’s daily life – her afternoon work for Aksion Plus, inventory at her family’s store, and her evening plans with her 5-year-old son.

“I do this every day for him,” she explains,

“He is my reason for living.”

STARTING TO TALK

Ortencia first injected when she turned 16 years old. Now, at 27, her body is a testament to her long road of recovery. Her bright eyes and wide smile give way to a past naivety, yet her calm, earnest poise reflect her learned maturity and inner grace.

“In the way I started, I didn’t know what I was doing,” Ortencia recalls. Her teenage boyfriend introduced her to heroin, promising it would “take away the stress” of high school peer pressure and her parent’s threats of divorce. She was injecting regularly by the time she turned 18 years old. “I was injecting in dangerous places. One time I had swelled legs for two months, and it hurt to urinate,” she adds. Then, she pulls back her white jeans to reveal small, deep black holes at her hip sockets.

“I was even doing it when I was pregnant,” Ortencia admits,

“After delivery I said I would stop it. But three months later I was injecting again.”

She shakes her head and looks at Ngjelina. Ortencia has gone through MMT twice before. During her last treatment, Bashllari was afraid she was continuing to inject while taking methadone – a dangerous combination that often causes overdose.

“She used to come in here looking thin and exhausted. She couldn’t even open her eyes,” Bashllari remembers.

When Ortencia was caught diverting (stealing methadone and exchanging it for heroin), Bashllari started tapering her dosage. Ngjelina kept asking for regular meetings, but Ortencia wanted to talk less and less.

“I was tired. I was tired of my problem,” Ortencia admits,

“I knew I had to stop. So one day I went to Enkelejda, and then to Altin. I started to talk and they listened.”

“Methadone really plays only a 20% role in getting a user to quit – patients must change the very ways in which they live their lives,” Bashllari explains. A change in jobs, friends, diet, and support system all play an important part in helping a drug user from falling back into the cycle of addiction.

For Ortencia, all of these factors came together for her third attempt with MMT. She is proud to state she has not used heroin for three months.

“I started to get more involved at home. I help with our family’s store,” Ortencia explains.

“When I was using heroin, my father was very angry, and my mother was not listening to me. But now, things are much better. And I am happier now that I spend more time with my son.”

“I am pleased with Ortencia’s attitude. This time I can see the treatment working. We see it in how she behaves,” Bashllari notes,

“She has a real desire to talk when I meet with her now. She is actively involved in making a difference for herself.”

At the picnic table, Ngjelina and Ortencia discuss the importance of Ortencia’s support system – both outside and within these ivy walls.

“Building trust is such an important part of this treatment,” Ngjelina says,

“We have an relationship wherein what trust I give, she gives back.”

Recently, Ortencia has been giving even more – especially to others.

SPIRIT OF ADDICTION

Two months ago, Aksion Plus hired Ortencia as an outreach worker, responsible for meeting with injecting drug users and explaining the services available at Aksion Plus. Most afternoons, she makes an effort to meet with fellow drug users and pass out information about MMT.

Ortencia is one of two female outreach workers, making her a particularly valuable member of the Aksion Plus team. For the most part, female drug users are not as involved in the culture or communities that form among heroin users. It is more common for female heroin injectors to be financially supported by their families or other male drug users.

“Women are harder to locate than men. But I can reach out to them easier than the boys. I know the language of which they speak,” she says,

“I can relate to women, particularly mothers – I know what they are going through.”

“She is a model for many female drug users who want to change,” Bashllari says,

“Her experience is very valuable, and she can spread the information easily.”

In white, she even looks like a white little Methadone Pill. For some drug users, she is their only dose of routine in a chaotic world.

Ortencia takes pride in helping fellow drug users. “This is my way to stop people from starting,” Ortencia explains,

“To stop this spirit of addiction.”

A new face passes by the picnic table. Ortencia jumps up to greet her friend, a young drug user. They have shared many in-depth discussions about sniffing and injecting heroin, and the risks of HIV. She had invited him to explore Aksion Plus a few days ago. She is pleased to see he decided to drop by.

She introduces him to Ngjelina, who invites him inside for an informal interview. They head for the greenhouse. Ortencia stays behind, finishing her cigarette and relishing in the shade if only for a few moments more.

Ngjelina turns and thanks Ortencia with a smile. Ortencia waves,

“Until tomorrow,” she says.

Ortencia then ducks out from the ivy-enclosed repose of Aksion Plus – back into the noise and heat of Tirana’s streets. It’s all part of the routine.

